

# GAZETA SHQIPTARE



Kryeredaktor: Erl MURATI  
Zv/kryeredaktore - Rezarta DELISULA  
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail:gazetashqiptare@hotmail.com



Viti XXIV - Nr. 7649 E mërkurë 12 Shtator 2018 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)

## Opinion *i* Ditës

Pas disa ditësh shkollat tona do të hapin dyert për fillimin e vitit të ri shkollor. Drejt tyre, përveç mësuesve dhe nxënësve, siç është bërë zakon, do vërshojnë ...  
Vijon në faqen 20

## Nga ANDON ANDONI

Zoti dhe shkolla!



## Dje në "Deutsche Welle"

Shokëve të idealit, ministri i Brendshëm italian, Matteo Salvini i uroi gjithë të mirat për votimet. Në Itali partia e tij "Lega Nord" është politikisht shumë ....  
Vijon në faqen 21

## Nga CHRISTOPH HASSELBACH

Politika kthen djathtas kudo në Europë



PS: SPAK dhe reforma janë garanci

## Vetingu, PD: 200 emra në "listën e zezë". Moisiu: Pas gjyqësorit, politika

Ish-presidenti: "Peshku i madh" është figurativ, ne i dimë kush janë "balenat"

Nga VALENTINA MADANI

Opozita përmes grupeve të përbashkëta, PD dhe LSI, nisën dje diskutimet për projektligjin e vetingut të politikës. Në këtë mënyrë, opozita iu rikthye punimeve të Kuvendit, por duke zhvilluar mbledhje paralele në ambientet ...  
Ne faqet 2-3

## TABELA ME MASEN E SHTUAR/ QEVERIA: KA HYRE NE FUQI ME 1 SHTATOR

# RRITJE PENSIONESH PER INVALIDET E TE VERBRIT

Përfitimti për personat me aftësi të kufizuar, do marrin 10.540 lekë në muaj.

ISSH: Pensioni nuk mund të jetë më pak se 75% e pagës minimale neto



(Në foto) Persona me aftësi të kufizuara gjatë një proteste

## KESHILLI I PDIU

**Idrizi ndahet nga PS, merr mandatin për negociata me PD**

Në faqen 4

## DJALI I KRYEMINISTRIT

**Sot çelet ekspozita, Vladimir Myrtezai: Një "Fidem" nga Greg Rama**

Në faqen 19

## TEKNOLOGJIA

**Transmetimi dixhital, AMA shtyn me 4 muaj afatin e analogut**

Në faqen 5

## INTERVISTA

**Sfidat e një vaje të kolme, Elda Kocia: Luftë me shoqërinë kundër paragjykitimit**

Suplement

## AVOKATI: HETIM PA PROVA



**Shtyhet pretenca për Shullazin, prokurori: Kohë të njoh dosjen**

Në faqen 9

Dëmshpërblimi/ Hiqet kufizimi për numrin e kësteve për ish-të dënuarit që jetojnë

## Skema e re, të përndjekurit që marrin paratë

Ahmetaj: Përfitojnë 1200 veta. Braçe: Të ngushtohet rrethi i përfituesve

NGA ORNELA MANJANI

Ndërshon skema për dëmshpërblimin e ish-të dënuarve politikë, nga i cili përfitojnë rreth 1200 dosje. Ministri i Financave, Arben Ahmetaj bëri të ditur se për ish-të dënuarit politikë që janë gjallë hiqet kufizimi për



shumën maksimale të kësteve. "Në mos gabohem janë rreth 1200 dosje, parësore dhe joparësore që do përfitojnë nga ky ndryshim ligjor. Nëpërmjet kështit të 9-të, ne do të mbyllim të gjithë pjesën e kategorisë parësore: të atyre që kanë ...  
Në faqen 6

# VETINGU NË POLITIKË REAGIMET

Darina Tanushi

Ish-presidenti Alfred Moisiu në një intervistë për "News 24" e "BalkanWeb" përshëndet nismën e opozitës për veting në politikë, por shton se procesi nuk mund të mbyllet pa përfunduar më parë vetingu në gjyqësor. Ish-presidenti vlerëson se forcat politike duhet të çojnë vendin përpara, ndaj edhe marrëveshjet mes dy kundërshtarëve politikë nuk duhet të mungojnë për të mirën e vendit.

### Keni një koment për zhvillimet e fundit në politikë?

Kohët e fundit politika ka shumë fenomene dhe shumë ngjarje. Për shembull, unë nuk jam dakord me mënyrën se si po trajtohet parlamenti. Është bërë modë tani çështja e bojkotimit. Bojkotimi është një masë, një veprim politik, por në qoftë se bojkotimi bëhet dora-dorës, javë për javë e muaj për muaj e humbet sensin e reagimit politik. Në Kuvend zgjidhen problemet, ndaj quhet Kuvend, kuvendohet. Po nuk u le të diskutosh me palën tjetër, të ballafaqohesh, jo duke sharë siç ka ndodhur deri tani për fat të keq, por duke shkëmbyer mendime, duke sjellë argumente sepse vetëm me argumente mund ta detyrosh tjetrin të bëjë ndryshime, të ndryshojë ligjin apo mendimin.

### Sa i përket vetingut në politikë...

Sigurisht vetingu në politikë është i domosdoshëm. Unë këtë mendim e kam thënë prej kohësh, por vetingu në politikë nuk mund të bëhet pa mbaruar vetingu në gjyqësor, pa mbaruar reforma gjyqësore, sepse ata që do dalin me probleme nga vetingu në politikë kush do t'i gjykojë, kush do t'i hetojë, ku do ankohen? Pra, duhet të pastrojmë gjyqësorin, ta bëjmë gjyqësorin ashtu siç është menduar, sipas reformës, pastaj të fillojë vetingu në politikë. Por, vetingu në politikë është i domosdoshëm, sepse në fund të fundit e gjithë këtë situatë negative që kemi pas 27 vjetëve ka një përgjegjësi. Përgjegjësitë i ka klasa politike, jo e gjitha sigurisht, por ata që kanë qenë në krye. Ata që kanë qenë në krye kanë abuzuar, kanë menduar më shumë për veten se sa për vendin, më shumë për partinë se sa për vendin, më shumë për klanin e vet se sa për vendin. Njeriu zgjidhet, emërohet në një detyrë për t'i shërbyer vendit të tij, popullit të tij dhe jo për të abuzuar. Në qoftë se njeriu vihet në një detyrë dhe mendon 'tani erdha këtu, ç'është vërdh', po flasim shqip se më vjen rëndë ta përdorim këtë fjalë, vërdhtë më vjen rëndë sepse është një fjalë që nuk i përshatet një politikani. Një

Ish-presidenti, kundër bojkotit të opozitës: Problemet të kuvendohen

## Alfred Moisiu: Vetingu në politikë i domosdoshëm, por të bëjmë gjyqësorin

"Peshku i madh' figurativ, por ne i dimë 'balenat'"



Ish-presidenti Alfred Moisiu

hajdut nuk mund të hyjë në politikë dhe nuk duhet të hyjë në politikë, por ka ndodhur për fat të keq tek ne. Pikërisht kjo është rruga që ne duhet të kalojmë. Duhet ta përshpejtojmë reformën në drejtësi se pavarësisht se i kanë votuar të gjitha ndryshimet kushtetuese me 140 vota, diçka e paparë, e pandodhur deri tani, por gjatë zhvillimit janë vënë stërkëmbësia dhe ato kanë krijuar një situatë që është vërtetë e rëndë. Është jashtë funksionit Gjykata Kushtetuese. Është e mbingarkuar dhe e papërbalueshme situata në Gjykatën e Lartë, por po të shikosh pse ka ardhur kjo, del pikërisht se nuk janë ndërtnuar institucionet që do kompletin këto gjykata për të zëvendësuar personat që janë quajtur nga reforma të panevojshëm për të vazhduar më tej.

### A mendoni që Rama dhe Basha kanë marrëveshje akoma?

Unë nuk dua të hyj në sekretecat që zakonisht bot-

on shtypi ynë. Nëse duhet të bëjmë marrëveshje, duhet ta bëjmë dhe këtu puna nuk është marrëveshja, por forcat politike shqiptare kanë detyrë që ta çojnë këtë vend përpara dhe qerria do të buaj, nuk ecën me një. Nëse njëri tërheq këtë dhe tjetri andej, qerria nuk ecën, rri në vend. Sigurisht që njëri është kryesori, ai që ka pushtetin e plotë, por edhe tjetri duhet të bëjë punën e tij. Nuk duhet të mendohet që pala kundërshtarë t'i vërë shkopinj nën rrota. Nëse pala kundërshtarë ngrihet çdo ditë kjo është keq, duhet t'i duhet ta argumentosh me fakte e jo me lafe, sepse tani ka shumë gjëra që janë ngritur, por nuk fakturohen. Atëherë duke luftuar përçart, se kështu mund të quhet, atëherë humbet vlerat, por se nuk arrihet arsyeja e vërtetë dhe çfarë duhet rregulluar.

### Një koment për deputetin e Kurbinit, Gjetan Gjetani dhe kryeministrin?

Nuk mund t'i hyj asaj pune. Ato janë punë partish.

### Mendoni se mes PD-së dhe LSI-së ka një koalicion të vërtetë?

Ato janë në opozitë, janë dy forca të rëndësishme politike shqiptare. Kanë pjesën tjetër të parlamentit, rreth 40% të forcovë dhe është pjesë e konsiderueshme. Pa ata nuk mund të merrren vendime të rëndësishme për ndryshime kushtetuese dhe ligje që kërkojnë 2/3. Normalisht duhet të kenë një bashkëpunim, në çfarë shkalle arrin e si e mbajnë, është punë e tyre.

### Ambasadori i Amerikës iku pa e kapur 'peshkun e madh', a mendoni se do të ketë ndonjë ambasador amerikan që do ta kapë 'peshkun e madh'?

"Peshku i madh" është në mënyrë figurative, se "balenat" ne i dimë se kush janë, nuk ka nevojë, sepse edhe një fëmijë i vogël i di. Por problemi qëndron në faktin se kjo punë duhet bërë nga organet dhe për këtë duhet të kalojë reforma në drejtësi.

**PJERIN NDREU**  
Deputeti i PS-së, Pjerin Ndreu, deklaroi dje se, "reforma në drejtësi dhe ngritja e SPAK janë e vetnja garanci për veting të thelluar në politikë. Çdo manovër tjetër është tentativë për t'i shpëtuar ndëshkimit. Veting në politikë pa drejtësi të pastruar nuk ka si të ketë!", shkroi dje në "FB" Ndreu.

### Nuk mund t'i hyj asaj pune. Ato janë punë partish.

### Mendoni se mes PD-së dhe LSI-së ka një koalicion të vërtetë?

Ato janë në opozitë, janë dy forca të rëndësishme politike shqiptare. Kanë pjesën tjetër të parlamentit, rreth 40% të forcovë dhe është pjesë e konsiderueshme. Pa ata nuk mund të merrren vendime të rëndësishme për ndryshime kushtetuese dhe ligje që kërkojnë 2/3. Normalisht duhet të kenë një bashkëpunim, në çfarë shkalle arrin e si e mbajnë, është punë e tyre.

### Ambasadori i Amerikës iku pa e kapur 'peshkun e madh', a mendoni se do të ketë ndonjë ambasador amerikan që do ta kapë 'peshkun e madh'?

"Peshku i madh" është në mënyrë figurative, se "balenat" ne i dimë se kush janë, nuk ka nevojë, sepse edhe një fëmijë i vogël i di. Por problemi qëndron në faktin se kjo punë duhet bërë nga organet dhe për këtë duhet të kalojë reforma në drejtësi.

### Një koment për Berishën dhe Metën?

Nuk merrem me vlerësimin e ish-kolegëve të mi dhe atyre që janë mbas meje. Nuk

kam asnjë koment.

### Për sa i përket situatës në Kosovë, për çështjen e ndryshimeve të kufijve?

Për sa u përket zhvillimeve të fundit, duhet thënë se u pa se gjithçka ishte thjesht një fluskë sapuni, edhe pse aty pati një esencë reale. Pasi duhet kuptuar se kjo situatë nuk mund të vazhdojë përjetësisht, që Serbia të mos e njohë Kosovën, që shqiptarët të jenë në luftë morale me serbët. Kjo vërtet është një luftë shekullore, por tani jemi në shekullin e 21 dhe gjërat duhet të ndryshojnë, nëse të dyja palët duan të hyjnë në BE. Unë gjithmonë përdor një shprehje "miqtë dhe shokët mund t'i zgjedhësh, por fëmijët t'i jep Zoti".

Ne qëlluam në këtë situatë me serbët. Unë nuk mund të futem të caktoj përgjegjësitë që ka Serbia në këtë punë, por neve na takon që këtë problem ta zgjidhim me shumë maturi, pa demtuar asnjërin palë. Por, kjo gjë do të ndodhtë më mirë nëse shqiptarët dhe serbët do të ulen dhe ta zgjidhin vetë dhe jo me mbikëqyrjen e të tjerëve. Pasi kur të tjerët ndërhyjnë, përzihen edhe inter-



Gjatë një seance parlamentare

esa të tjera, në këtë rast interesante e Ballkanit përzihen me interesat e palëve me të mëdha ndërkombëtare. Të prekësh kufijtë është një përgjegjësi e madhe dhe në konflikte të tilla kemi Maqedoninë, me Greqinë etj. Madje, njësoj si ne ka edhe Bosnja, por ama është vënë re se Serbia akoma vazhdon me idenë e një Serbie të madhe. Nëse do shikosh me vëmendje politikantët e Serbisë që tentuan të bëjnë diçka ndryshe, dështuan. Kjo, pasi në zonat rurale të vendit akoma njerëzit kanë idenë e një Serbie të madhe. Që Shqipërisë i janë bërë padrejtësi, kjo tashmë dihet. Gjithçka ka filluar që nga Kongresi i Berlinit, Konferenca e Londrës dhe këto janë pasojë që nuk fshihen kollaj. Kosovën e mbajti një shekull në robëri, por Kosova jo vetëm mbijetoi, por u forca nga pikëpamja e ndjenjës patriotike. Dhe kjo s'oli si pasojë luftën. Çdo vendim i gabuar ndërkombëtar sjell pasojë të mëvonshme. Unë e përmdena edhe më parë shprehjen e Edit Durhamit të vitit 1905, edhe kjo vendosje kështu, pa e njohur situatën sjell situatë të përgjakura ndër shekuj e vite.

### Mendoni që vetingu gjyqësor në Shqipëri do të mbyllet brenda këtij viti, apo do të zgjasë edhe më shumë?

Dëshira është që të mbyllet, por duke gjykuar nga ritmet sesi po ecin, kam frikë se nuk do të mbyllet. Madje, jo vetëm kaq, por shoh disa vendime që nuk janë shumë bindëse. Nuk mund të pyesësh dikë se pse ka shtëpi, sepse të gjithë kanë shtëpi. Del kollaj ai që ka abuzuar. Nuk do shumë zotësi për t'u gjetur, por duhet bërë kujdes. Unë kam një thirrje për t'u bërë njerëzve që janë zgjedhur në krye të këtyre institucioneve: të kenë kujdes, pasi do veprim gjykohted dhe ka pasojë!



## Spiropali: PS do një veting të plotë, Luli do që atë ta bëjë Saliانji e Klevisi

Jemi të hapur për të biseduar me opozitën për vetingun, por për një veting që politikantët të përballen me drejtësinë dhe vetingun e politikës ta bëjë drejtësia e pavarur", deklaroi dje në një konferencë për mediat, deputetja e PS-së, Eliza Spiropali. Sekretarja për Bashkëqeverisjen dhe Aleancat, njëkohësisht nënkryetaria e grupit parlamentar të PS, Eliza Spiropali u shpreh se Partia Socialiste është për veting të politikës. "Ne duam që ata që s'e kalojnë vetingun, të përballen me drejtësinë. Luzlimi Basha thotë 'jo'. Shqiptarët duan që vetingun e politikës ta bëjë drejtësia e pavarur, Luzlim

Basha thotë 'jo'. Luzlimi do që kontrollin t'ia bëjë Saliانji me Klevisin, kjo nuk është drejtësia që duam. Ne duam veting dhe jemi të hapur për të biseduar, por një veting të plotë", tha Spiropali. Më tej, Spiropali u shpreh se, "ata thonë, hajde voto diçka që dhe sot vetë nuk janë gati e që për më tepër është hap pas. Propozimi i tyre është ta marrësh reformën në drejtësi dhe ta grisësh". Po ashtu, Spiropali shtoi se, "Luzlim Basha mund të ketë frikë nga SPK dhe BKH, por kjo nuk është arsye që ne t'i vëmë shkelmin vetingut, që njësoj siç po nastron drejtësinë nga të korruptuarit dhe të paafët, do të pastrojë dhe politikën".





Kush do ta bëjë vetingun e politikanëve? Salianji: E vendosim pasi ta votojë qeveria

# Nis diskutimi për vetingun, PD: 200 emra në 'listën e zezë'

*Mblidhen komisionet paralele në Kuvend*

Valentina Madani

Opozita përmes grupeve të përbashkëta, PD dhe LSI, nisën dje diskutimet për projektligjin e vetingut të politikës. Në këtë mënyrë, opozita i rikthehe punimeve të Kuvendit, por duke zhvilluar mbledhje paralele në ambientet e Kryesisë së Kuvendit. Grupi i PD dhe ai i LSI-së u mblodhën për platformën e re të opozitës edhe për procesin e diskutuar gjerësisht së fundmi, atë të vetingut të politikës. Ndërsa Komisioni i Ligjeve, kryesuar nga socialisti Manja u mblodh pa deputetët e opozitës, ndërkohë që kolegët e opozitës po zhvillonin mbledhjen në sallën ngjitur, aty ku janë edhe sallat e grupit të LSI-së, aty ky Monika Kryemadhi zhvillon takimet me delegacionet parlamentare. Mbledhjen pa praninë e medias e kryesoi deputeti i PD-së, Ervin Salianji, emëruar nga Lulzim Basha si koordinator i grupit, që do të merrtet me çështjen e dekriminalizimit të plotë përmes vetingut në politikë. Ai akuzoi se kryeministri Edi Rama dhe PS nuk e duan vetingun dhe po e refuzojnë. Sipas tij, vetingu në politikë ecën paralelisht me vetingun në drejtësi dhe nuk e shmang. Deputeti i PD tha se nuk ka negociata mazhorancë-opozitë. "Propaganda që bëhet nga PS dhe Rama është që t'i shmangen vetingut të politikanëve. Vetingu është një proces paralel, që ecën nga drejtësia. Nuk e shmang vetingun i politikanëve hetimin nga drejtësia, përkundrazi e ndihmon dhe largon personat e inkriminuar. Ne jemi duke e detajuar të gjithë platformën për largimin e personave të inkriminuar. Rama nuk e do vetingun dhe refuzon të votojë propozimin tonë të depozituar në Kuvend. Ne mund të gjëjmë çdo hapësirë procedurale për ta kaluar sa më shpejt në komisionet kuvendore apo dhe në seancë parlamentare për ta votuar thjeshtë, po ose jo!", theksoi z. Salianji. I pyetur se cili do të jetë organi që mund të bëjë vetingun e politikanëve kur opozita nuk ka besim tek institucionet, Salianji tha se çdo gjë vjen me ndryshimet kushtetuese. "Do bëhet hap pas hapi. Ne kemi një plan të detajuar, që do ju bëhet i qartë sapo qeveria të shprehet e do apo jo vetingun. Ne kemi depozituar një projektligj që i parashikon të gjitha ndryshimet kushtetuese për të bërë vetingun e politikanëve. I gjithë procesi i



Deputeti i PD-së, Ervin Salianji



Deputeti i PD-së, Enkelejd Alibeaj

**ENKELEJD ALIBEAJ**

"Jemi pa Gjykatë Kushtetuese, pa SPAK dhe pa BKH. Jemi pa mundësi të kontrollojmë pushtetin prej pushtetit gjyqësor. Mungon elementi bazë i ndarjes së tri pushteteve. Sistemi gjyqësor nuk ekziston në për shkak të vetingut. Është situatë, e cila kërkon zgjedhje. Ajo që po ndodh me reformën nuk është thjesht kapje politike", theksoi Alibeaj.

**ERVIN SALIANJI**

Deputeti i PD-së, Ervin Salianji deklaroi se rreth 200 politikanë janë pjesë e 'listës së zezë' dhe se duhen hetuar nga vetingun në politikë. I ftuar në "News 24" deputeti demokrat risolli në vëmendje rëndësinë e vetingut në politikë, nismë kjo e ndërmarrë nga PD-ja.



**Largimi i ekspertit, Vasili: Policia është marrë peng nga të paafët**

Petrit Vasili, kryetari i grupit parlamentar të LSI-së, duke marrë shkas nga dorëheqja e ekspertit të Policisë Shkencore, Viktor Hajdari, shprehet se largimi i të aftëve është një tragjedi e vërtetë. "Policia është marrë peng nga të paafët, a është kjo në favor të kimit? Një nga ekspertët më të mirë të Policisë Shkencore, Viktor Hajdari jep dorëheqjen për shkak të klimës mbytëse, asfiksuese dhe injorancës së dukshme në drejtimin e institucionit të Policisë Shkencore. Por, qytetarët kanë disa pyetje të mëdha: A e di kryeministri rëndësinë e jashtëzakonshme të Policisë Shkencore? A ka kaq shumë punonjës të nivelit të lartë shkencor që Shqipëria të ketë luksin t'i largojë? A mund të zbulohet veprimtaria kriminale pa polici shkencore cilësore? A luftohet krimi me injorancë teknike? A favorizohet krimi kur fuqia zbuluese dhe e ekspertizës bie? A mos është pikërisht ky synimi i kryeministrit që krimet të mos zbardhen? A mos është ditë e mirë për krimin, largimi i ekspertëve të aftë dhe ditë e zezë për qytetarët? Në këto momente kur krimi është kryeçështja e çdo qytetari dhe priten mesazhe ndryshimi, largimi i të aftëve dhe triumfi i shkollëpakevë, që nga kryeministri e me radhë ministria e drejtorë & co është një tragjedi e vërtetë. Po presim të dëgjojmë sharjet idiotë të qeverisë për ekspertin Hajdari dhe shpjegimet akoma më idiotë të ministrisë që të justifikojnë gjithçka, megjithatë turpi atyre do t'u mbetet dhe krimi do të fërkojë duart i kënaqur", tha z. Vasili.

**"Dy të plagosur me thikë në Kavajë"**

**Denoncimi te Berisha: Policia mori me USB pamjet e kamerave**

Ish-kryeministri Sali Berisha publikoi dje një mesazh. Sipas tij, tre oficerit të Shërbimit Informativ në Shkodër, sipas të cilit, tre oficerë policie në qytetin verior janë përfshirë në veprimtari kriminale. Sipas mesazhit të publikuar nga Berisha, këta punonjës kanë lejuar kalimin e 100 kg drogë. Po dje ish-kryeministri Sali Berisha, në vijim të akuzave për gjendjen e krimin në vend, postoi një denoncim për dy ngjarje të fundit që kanë ndodhur në Kavajë. Duke iu referuar mesazhit të qytetarit dixhital, Berisha shkruan për dy të plagosur me thikë në Kavajë, kurse policia, sipas denoncimit të qytetarit jo vetëm ka fshehur ngjarjen, por edhe ka marrë pamjet e kamerave me USB. "Narkopolicia fsheh krimin. Dy plagosje me thikë në Kavajë! Lexoni mesazhin e qytetarit dixhital. 'Dy të plagosur me thikë dje në mbremje në Kavajë, policia po fsheh ngjarjen, janë kamerat e lokalit, që policia i mori me USB. Sipas fjalëve po mundohet të fshehin ngjarjen pa e bërë publike", thuhet në denoncimin e z.Berisha.



vetingun do të nisë edhe nga drejtuesit e institucioneve publike. Ne edhe sot nuk kemi besim në këto institucione, mekanizmi është i përcaktuar në ndryshimet kushtetuese. Vendimi ynë është që do të pranojmë apo diskutojmë çdo lloj hapi për të përshpejtuar në Kuvend

projektligjin", deklaroi deputeti demokrat. Një tjetër grup i opozitës është ai që synon të evitojë atë që PD e quan kapje të drejtësisë e që ka koordinator Enkelejd Alibeaj. "Jemi kthyer 46 vite prapa me një sistem që i mungon minimumi bazë i demokracisë, ndarja e pushteteve. Drejtësia e kapur nga qeveria, qeveria e kapur nga krimi", tha Enkelejd Alibeaj. Ai pohoi se hapat e ardhshme të opozitës do të përcaktohen në mbledhjet e tjera të këtyre grupeve, me të cilat duket se opozita po kërkon të zëvendësojë komisionet e parlamentit. "Ky parlament nuk ekziston më dhe sistemi gjyqësor nuk ekziston më për shkak të asaj që quhet reforma në drejtësi, sot ka një qeveri dhe një kryeministër, i vetmi. Kjo është situata dramatike që na rezultoi në përfundim të mbledhjes. Kjo situatë kërkon zgjedhje, sepse ajo që po ndodh me reformën në drejtësi nuk është vetëm kapja politike, por kapja politike nga një mazhorancë që ka futur në shtetullën e vet, në mos është njëshuar me krimin. E rëndë si situatë. Ajo që diskutuam është gjetja e zgjidhjeve. Gjetja e zgjidhjeve shkon paralelisht edhe me gjetjen e zgjedhjeve edhe për rastin e vetingut në politik, edhe me sistemin e çlirimit të ekonomisë edhe sigurisht me sistemin zgjedhor", theksoi z. Alibeaj. Sipas tij, ka një platformë me 7 pika, ku përcaktohet se cilat janë piketat për të arritur në çlirimin politik të sistemit të drejtësisë.

## ZGJEDHJET VENDIMI

PDIU, drejt koalicionit me opozitën, Idrizi: Gabova që ia besova Ramës çështjen çame

# PDIU ikën nga PS, Idrizi merr mandat për negociata me PD

## "Rama e mori të gjithë 'tepsinë' për vete"

Valentina Madani

Partia Drejtësi, Inte grim dhe Unitet (PDIU) braktisi dje zyrtarisht koalicionin qeverisës, duke u hapur rrugën bisedimeve me PD-në për zgjedhjet e ardhshme lokale. PDIU-ja mblodhi dje në orën 17:00 Këshillin Kombëtar të partisë, aty ku u zyrtarizua ndarja nga mazhoranca. Shpëtim Idrizi është caktuar si negociator i PDIU-së me Partinë Demokratike. Kreu Shpëtim Idrizi i propozoi Këshillit Kombëtar që PDIU të dalë nga koalicioni me të majtën dhe t'i bashkohet frontit opozitar. Idrizi e paralajmëroi më herët largimin nga aleanca me PS teksta tha në 'TCH': "Nuk dua t'u referohem emrave të përveçëm, por ajo që mund të them qartësisht sot është se në kushtet kur kjo mazhorancë e ka marrë të gjithë 'tepsinë' për vete dhe deklaroi se do të hyjë e vetme në zgjedhje, e në kushtet që për çështjen e shqiptarëve të Çamërisë kemi ndryshim 180 gradë të qëndrimit të kësaj mazhorance dhe të Edi Ramës, në mbledhjen e para dy ditëve të Kryesisë së PDIU-së vendosëm mbledhjen e Këshillit Kombëtar për të diskutuar për kalimin në opozitën zyrtare dhe mundësitë e negociatave me Partinë Demokratike, për t'u rreshtuar në këto zgjedhje me koalicionin opozitar". PDIU u largua nga koalicioni i djathtë në 2014-ën, pasi në zgjedhjet parlamentare të 2013-ës siguroi pesë mandate, ndërsa Idrizi u zgjodh në listat e PD. Koalicioni me PS nuk funksionoi, ndërsa në zgjedhjet e qershorit 2017 PDIU arriti të marrë vetëm 3 mandate, dy në Elbasan, Aqif Rakiqi dhe Bujar Muça (të dy të larguar më pas, i pari për efekt të dekriminalizimit dhe i dyti dorëzoi mandatin) dhe një në Dibër (Reme Lala).



Kreu i PDIU Shpëtim Idrizi

### DEKLARATA

"Në mbledhjen e para dy ditëve të Kryesisë së PDIU-së vendosëm mbledhjen e Këshillit Kombëtar për të diskutuar për kalimin në opozitën zyrtare dhe mundësitë e negociatave me Partinë Demokratike, për t'u rreshtuar në këto zgjedhje me koalicionin opozitar", tha Idrizi.



Kryeministri Edi Rama dhe kryetari i PDIU Shpëtim Idrizi



### SHKEPUTJA

Koalicioni me PS nuk funksionoi, ndërsa në zgjedhjet e qershorit 2017, PDIU arriti të marrë vetëm 3 mandate, dy në Elbasan, Aqif Rakiqi dhe Bujar Muça (të dy të larguar më pas, i pari për efekt të dekriminalizimit dhe i dyti dorëzoi mandatin) dhe një në Dibër (Reme Lala).

## Presidenti krah Berishës, një mesazh për demokracinë

### "Demokracia nuk pret", Meta: Vepra e Frank Shkrelit, shkundje për politikën

Presidenti i Republikës, Ilir Meta, u shfaq dje krah ish-kryeministrit Sali Berisha në promovimin e librit të Frank Shkrelit, i cili bëri bashkë dy liderët, dikur aleatë. Fotot u publikuan nga kreu i shtetit në "Facebook", ku tregon edhe për aktivitetin që i ka mblodhur. Publicisti dhe gazetari shqiptaro-amerikan, Frank Shkrelit promovoi librin "Demokracia nuk pret". Vepra përmban artikuj të ndryshëm që Shkrelit i ka shk-

ruar në 10 vitet e fundit, ndërsa kreu i shtetit, Ilir Meta tha se libri i kujton politikës se detyra e saj kryesore është mbrojtja e demokracisë. Libri u promovua me prezencën e figurave të njohura të politikës dhe medias. Presidenti Ilir Meta tha se kjo veprë duhet të shkundojë politikën që të angazhohet në mbrojtje të demokracisë. "Demokracinë nuk ta dhuron askush, demokracinë duhet ta fitosh dhe mund ta fitosh çdo ditë e më shumë, por edhe mund ta humbasësh çdo ditë e më

shumë. Në këtë drejtim, vepra e zotit Shkrelit është edhe një shkundje për të gjithë, për rëndësinë që ka demokracia. Ajo nuk është e dhënë një herë e përgjithmonë. Demokracia duhet ruajtur, duhet mbrojtur, duhet zhvilluar sipas standardeve më të avancuara dhe siç e meriton një komb si i yni, që ka vuajtur shumë nga mungesa e saj", deklaroi z.Meta. Vetë Shkrelit shkruan në libër se demokracia nuk ka përzënë vetëm demokracinë. "Duhet të jemi të sinqertë me veten dhe të



tjerët se shqiptarët i ka penguar diçka që të zënë vendin e tyre ku u takon me kombet e tjera, se pranvera e demokracisë shqiptare si në Shqipëri, Kosovë dhe anembanë trojeve sh-

qiptare nuk ka çelur ende lulet që prisnim dikur dhe për të cilat presim gjithnjë. Prandaj kemi ruajtur titullin 'Demokracia nuk pret' për të tria vëllimet", deklaroi z.Shkrelit.

### NEGOCIATAT

Kryetari i PDIU, Shpëtim Idrizi, nga mbledhja e Këshillit Kombëtar mori përgjegjësinë e mosrealizimit të kërkesave për çështjen çame në negociatat Tiranë-Athinë për zgjidhjen e problemeve mes dy vendeve. Ai tha se gaboi kur i besoi Edi Ramës zgjidhjen e kësaj çështjeje, ndërsa u shpreh se shpreson që marrëveshja e cila fshin Çamërinë nga to-

ponimet dhe tekstet shkollore të mos jetë e vërtetë. "Edhe unë kam bërë gabimet e mia, pasi mendova dhe besova se do e çonim para kauzën tonë me këtë mazhorancë. Por s'kam besuar se dikush mund të luante me fatet e pushtetit. Nuk e mendova se ne do ishim çakmak për rritjen e temperaturave dhe për të arritur marrëveshjen. Do doja që mos të ishte e vërtetë,

ndaj ky është faji im", tha z.Idrizi. Para anëtarësisë së Këshillit Kombëtar, kreu i PDIU u përgjigje deklaratave të kryeministrit grek, Aleksis Tsipras pak ditë më parë, teksa tha se çështja çame nuk ekziston. Shpëtim Idrizi i konsideroi si deklarata arrogante, ato të kryeministrit grek dhe se sipas tij, Greqia është i vetmi vend që nuk i njeh minoritetet. "Çështja çame

ndodhet në një moment delikat. Më duhet t'i jap një përgjigje kryeministrit grek, që tha me arrogancë se çështja çame nuk ekziston si dhe të tjerëve që thonë se janë në prag të një zgjidhjeje me Shqipërinë. Ne nuk çuditemi nga deklaratat arrogante tipike të një lideri në Ballkan si Cipras. Greqia nuk ka përzënë vetëm çamët, por edhe hebrenjtë dhe të tjerët. Greqia është i

vetmi vend që nuk i njeh minoritetet. Pala shqiptare thotë se ne kemi folur për çështjen çame, por Greqia nuk pranon. Kaq? Kjo nuk mjafton. Ne i jemi adresuar ministrit Bushati me 16 pyetje për të sqaruar opinionin publik se çfarë është diskutuar me palën greke", - tha Idrizi. Ai përmendi se në 4 vite janë larguar nga vendi 400 mijë shqiptarë, pasi iu është vrarë shpresa.





Opozita, letër institucionit: Vendimi bie ndesh me të drejtën kushtetuese

# Transmetimi dixhital, AMA rindez analogun.

## Rama: Jo pa siguruar akses për qytetarët

PD e LSI kërkojnë tryezë teknike brenda shtatorit

Darina Tanushi

Autoriteti i Mediave Audiovizive shtyu dhe fikjen e transmetimeve analoge për 4 muaj. AMA deklaroi se do të rindizen sërish transmetimet analoge dhe se sinjali analog i transmetimit do të fiket më 15 janar. Ndërkohë do të vijojnë transmetimet dixhitale për ata që kanë blerë aparatet. "Kemi vendosur rindezjen e transmetimeve analoge. Për ata që kanë blerë aparatet e ri, do të vijojnë që të shikojnë transmetimet dixhitale, ndërkohë që ata që ende nuk janë pajisur, u lihet katër muaj kohë për t'u pajisur me dekodera, do të shtyhet afati në 15 janar 2019. Me gjithë njoftimet prej një viti, konstatohet se shumë prej tyre e kanë lënë për një moment të fundit. Përpara se të vijë data 15 janar 2019, kini parasysh se dekoderi DVB-T2 kushton 2990. Ndërsa ata persona, të cilët kanë televizor të ri të tipit DVB-T2, e kanë të inkuorporuar dekoderin, që do të thotë nuk kanë nevojë të blejnë një të tillë të ri", u shpreh kreu i AMA-s, Gentian Sala, në një bashkëbisedim me gazetaret. Kryeministri Edi Rama reagoi dhe pas kësaj, duke thënë: "Zbatimi i normës europiane është një domosdoshmëri, por nuk fiket sistemi i vjetër pa siguruar akses për këdo në sistemin e ri".



**EDI RAMA**  
Kryeministri Edi Rama përhëndeti dje vendimin e Autoritetit të pavarur të Mediave Audiovizive për rindezjen e sistemit të vjetër të transmetimit televiziv. "Zbatimi i normës europiane është një domosdoshmëri, por nuk fiket sistemi i vjetër pa siguruar akses për këdo në sistemin e ri. E gjithë vëmendja për njerëzit", shkroi dje Rama në "Twitter".

### Ambasadori sllovak pritet nga Ruçi: Shqipëria në BE, interes për vetë Europen

Pranimi i Shqipërisë në Bashkimin Europian është jo vetëm në interes të Shqipërisë, por edhe të vetë BE-së dhe Europës". Kështu deklaroi dje ambasadori i Sllovakisë, Milan Cigánik, i cili u prit në një takim nga kryetari i Kuvendit, Gramoz Ruçi, me rastin e mbarimit të mandatit të tij në Shqipëri. Ambasadori Cigánik vuri po ashtu në dukje se, "Shqipëria po bën hapa të sigurt drejt familjes europiane dhe po krijon në këtë aspekt një përvojë, prej së cilës mund të mësojnë edhe vendet e tjera". Ruçi vlerësoi se, "marrëdhëniet politike të Shqipërisë me Republikën Sllovake janë shumë të mira". Shprehje e këtij vlerësimi, sipas tij, ishte edhe vizita e Kryeministrit të Sllovakisë në Tiranë gjatë mandatit të ambasadorit Cigánik. Ruçi shprehu vullnetin e Shqipërisë për zhvillimin e mëtejshëm të marrëdhënieve dhe intensifikimin e dialogut politik dypalësh. Ai vlerësoi mbështetjen e vazhdueshme të Sllovakisë në procesin e integritimit europian të Shqipërisë si edhe mbështetjen e Sllovakisë në kuadër të Grupit të Vishegradit. "Gjatë mandatit tuaj - vuri në dukje kryetari i Kuvendit - Shqipëria fitoi statusin e vendit kandidat". Duke vlerësuar mbështetjen dhe nxitjen e dialogut mes Beogradit dhe Prishtinës, kryetari i Kuvendit Ruçi përsëriti kërkesën që Sllovakia të njohë Kosovën si shtet sovran.

### Senida Mesi në Mal të Zi: Negocim kushteve tregtare

Zv.kryeministria Senida Mesi gjatë një vizite zyrtare në Mal të Zi ka takuar Milutin Simoviç, zëvendëskryeministër për Politikat Ekonomike dhe Sistemin Financiar, si dhe ministër për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural. Zv.kryeministria thotë se ka diskutuar me homologun malazez në lidhje me projektet me interes të ndërsjellë mes dy vendeve dhe më konkretisht, mbi negociimin e kushteve tregtare mes Shqipërisë dhe Malit të Zi, si dhe mbi veprimet konkrete që duhen ndërmarrë për liqenin e Shkodrës dhe lumin Buna, në kuadër të marrëveshjes së nënshkruar në mbledhjen e përbashkët të dy qeverive tona lidhur me menaxhimin e burimeve ujore ndërkufitare. "Ndamë bindjen e plotë se rezultatet e para të kësaj marrëveshjeje do të pajsojnë së shpejti", - u shpreh Mesi.

NJOFTIM SHITJE ME ANKAND

ZYRA PERMBARIMORE GJYQESORE PRIVATE 'ILIA ELEZI'

A. Pasuria nr. 26/ 319, e llojit 'truall', vol. 27, fq. 207, zk. 8642, sip. 10.000 m2, ndodhur në Sarandë, në pronësi të GRIGOR TAVO;  
B. Pasuria nr. 26/ 320, e llojit 'truall', vol. 27, fq. 208, zk. 8642, sip. 10.000 m2, ndodhur në Sarandë, në pronësi të GRIGOR TAVO;  
CMIMI 78.976.000 LEKË për secilin pasuri; në Total 157.952.000 LEKË. Data e zhvillimit të ankandit do jetë **26.09.2018**.  
CEL. 0684026666 ; 0693262866 .

### Sala: Sinjali do të fiket më 15 janar 2019, qytetarët të pajisen me dekoder

Kreu i AMA-s, Gentian Sala, në një konferencë për mediat deklaroi dje se sinjali analog do të rindizet edhe për katër muaj në Tiranë dhe në Durrës, deri në datë 15 janar të vitit 2019. Sipas tij, një vendim i tillë erdhi, pasi pas fikjes së sinjalit analog të hënën, në orën 10:00 ka pasur një numër jashtëzakonisht të lartë ankesash nga qytetarët, mbi një mijë vetëm në 24 orë, që nuk e kuptojnë si funksion dhe që nuk janë pajisur me dekodera. Për ata që kanë blerë aparatet e ri do të vijojnë që të shikojnë transmetimet dixhitale. Gjatë bashkëbisedimit me gazetaret, Sala tha: "Nuk na duket normale që dhjetëra qytetarë të mos të kenë të drejtë për informim, të rrinë në radhë për dekodera". Ai sqaroi se, "jo të gjithë TV kanë mundësi për të marrë transmetimet e gjeneratës së fundit. Dje ka pasur 700 ankesa, sot deri në mëngjes 180, numër jashtëzakonisht i lartë. Njerëzit pyesin çfarë do të bëjmë, ku do të blejmë dekoderat", tha Sala duke sqaruar se ky institucion ka një vit e gjysmë që ka informuar. "Informimi ka mbi një vit, shtresat vulnerabël kanë probleme me marrjen e informacionet, nuk e kuptojnë procesin, por ka edhe të rinj që nuk e kuptojnë, duhet bërë më shumë, duhet folur edhe me qeverinë, por nuk i ezauron 100%", u shpreh Sala.



Njeriut. Bazuar në raportet e Bankës Botërore rezultojnë se më shumë se gjysma e shqiptarëve jetojnë në varfëri. Në kohën që çdo qytetar paguan takson e aparateve televizive si pjesë e futurës

së dritave, e konsiderojmë një 'taksë' të shtuar. Dje ka pasur ballueshme, të panevojshme dhe abuzive blerjen e një dekorderi që do t'u sigurojë aksesin në informacion. Duhet të sjellim në vëmendje

jen tuaj se shteti dhe institucionet e tij kanë detyrimin jo vetëm të njohjes së të drejtave formalisht, por edhe të garantimit të tyre në praktikë", thuhet në ankesën e opozitës. Duke pasur parasysh sa më sipër dhe rolin tërësisht që luajnë mediat lokale në informimin e publikut shqiptar dhe mbulimin e të gjithë territorit, pamundësinë ekonomike të një numri shumë të madh qytetarësh për blerjen e dekoderave: faktin që çdo familje paguan tashmë takson e aparateve televizive në cilësinë e deputetëve të komisionit përgjegjës për çështjet e medias dhe të drejtën e informimit publik, kërkojmë nga anëtarët e Bordit të AMA-s: trajtimin me përparësi të kësaj çështjeje në mbledhjen e datës 12 shtator, mundësinë e rishikimit të vendimit për mbylljen e operatorëve lokalë në qarqet Tiranë e Durrës, shtyrjen e mbylljes së transmetimeve të tyre deri në një moment të dytë, kur shteti të ketë siguruar që çdo qytetar i Republikës së Shqipërisë të jetë pajisur me një aparat që do t'i mundësojë aksesin në informacionin publik mediatik". Po kështu, opozita kërkon nga AMA organizimin e një tryeze të ngushtë teknike në muajin shtator me përfaqësues të shoqatës, të AMA-s, RTSH-së, AKEP-it dhe palëve të tjera të interesuara, rishikimin e mundësisë së shtyrjes së afatit deri në momentin që çdo qytetar të ketë siguruar nga shteti një dekoder. Sipas opozitës, çdo vendim tjetër do të binte ndesh me të drejtat kushtetuese.

Miratoohen ndryshimet në ligj. Pagesa me një këst për dosjet që marrin 1 milion lekë

Ornela Manjani

Ndryshon skema për dëmshpërblimin e ish-të dënuarve politikë, nga i cili përfitojnë rreth 1200 dosje. Ministri i Financave Arben Ahmetaj bëri të ditur se ish-të dënuarit politikë që janë gjallë hiqet kufizimi për shumën maksimale të kësteve. "Në mos gabohem janë rreth 1200 dosje, parësore dhe jo parësore që do përfitojnë nga ky ndryshim ligjor. Njëpër një këstit të 9-të, ne do të mbylлим të gjithë pjesën e kategorisë parësore: të atyre që kanë vuajtur drejtpërsëdrejti dënimin", u shpreh Ahmetaj në Komisionin e Ekonomisë.

**KOMISIONI**

Gjatë diskutimeve, kryetari i Komisionit të Ekonomisë, Erjon Braçe kërkoi përjashtimin e brezit të tretë dhe të katërt të përfituesve, kjo edhe pse deri më tani trashëgimtarët kanë arritur deri në këstin e dytë nga 10 të tilla. "Ju duket normale që dëmshpërblimi të arrijë deri tek femija dhe fëmijët e vëllezërve dhe e motrave të atij që është përndjekur apo ka bërë burg politik? Me thënë të drejtën zoti Ministër, pavarësisht se kush është në pushtet, është Sali Berisha apo është Edi Rama, paratë janë para që krijohen nga taksat dhe tatimet e qytetarëve të Shqipërisë", tha Braçe. Ministri Ahmetaj u shpreh parimisht dakord me mendimin e kreut të Komisionit të Ekonomisë. "Zoti Braçe, nëse më pyesni mua si Arben Ahmetaj, por edhe si koleg i juaj në parlament, unë do të thosha që paratë e buxhetit të shtetit duhet të shkojnë tek e ardhmja, më shumë se tek e kaluara"-tha Ahmetaj. Buxheti i shtetit duhet të paguajë një faturë të kripur për të shpërblyer të gjithë ish-të përndjekurit politikë dhe trashëgimtarët e tyre, proces që për të 11 mijë dosjet mund të zgjasë deri në

# Ndryshon skema, Ahmetaj: 1200 ish-të përndjekurit që dëmshpërblehen

## Propozimi i Braçes: Të ngushtohet rrethi i përfituesve



Ministri i Financave, Arben Ahmetaj, dje në Komisionin e Ekonomisë

15 vite. "Buxheti i shqiptarëve do të paguajë nga 1.5-2 miliardë dollarë nga taksat e veta për çka ka ndodhur që nga viti 1945-1989. Do të paguajë brezi që vjen gati 1.5-2 miliardë dollarë në 8-15 vitet që vinë nga taksat e veta. Brezi që sot është 17, 18, 19, 20 vjeç", tha Ahmetaj.

**PAGESAT**

Ministri i Financave theksoi, gjithashtu, se dëmshpërblimet janë dhënë më së shumti për ata që kanë vuajtur në burgjet e komunizmit. "Njëpër një këstit të nëntë, ne do të mbylлим gjithë pjesën e kategorisë parësore, pra ata që kanë vuajtur drejtpërsëdrejti dënimin. Ka pasur një debat të gjatë edhe në parlament se çfarë ka ndodhur me ish-të përndjekurit politikë. Unë dua të ndaj me ju disa shifra, të cilat tregojnë se çfarë

ka ndodhur me ish-të përndjekurit. Po të vini re në vitet elektorale 2009 dhe 2013, ish-qeveria ka tentuar të përdorë buxhetin e shtetit me emocione elektorale ndaj këtij grupi. Në 4 vjet janë shpërndarë 7.9 mld, që nga 2014 deri në 2018. Sa i përket kategorisë parësore, në periudhën 2009-2013 kësaj kategorie i janë dhënë 1.5 mld lekë, ose 15 mln dollarë në 4 vite. 2014-2018 kategorisë parësore i janë dhënë 7.07 mld lekë, pra 70 mln dollarë. Ata që dikur kanë mbajtur flamurin se i kanë mbështetur këtë kategori, atyre që kanë vuajtur drejtpërdrejt i kanë dhënë 15 mln dollarë. Ndërsa deri më sot, brenda mandatit të parë të qeverisë kanë marrë 70 mln dollarë. Ndryshimi i dytë që paraqesim në ligj është ndryshimi i raportit mes parësorëve, 70 me 30, duke i dhënë

përparësi parësorëve"- deklaroi Ahmetaj.

**RELACIONI**

Në relacionin e ligjit thuhet se qëllimi i këtij projektligji është mundësimi i së drejtës ligjore që gëzojnë ish-të përndjekurit e regjimit komunist, të cilët janë ende në jetë dhe bëjnë pjesë në kategorinë parësore, të përfitojnë të gjithë shumën e miratuar të dëmshpërblimit financiar, sipas parashikimeve të kuadrit ligjor në fuqi. Gjithashtu, njëpër një këstit projektligji, synohet edhe përshejtimi i procesit të dëmshpërblimit financiar për familjarët e viktimave të burgosura, të ekzekutuara

**NDRYSHIMET SYNOJNË**

1. Përmbyljen përfundimtare të procesit të dëmshpërblimit për ata ish-të dënuar që kanë vuajtur vetë dënimin gjatë regjimit komunist, dhe janë ende në jetë;
2. Heqja e raportit të përcaktuar të fondit të miratuar, ku 70% i vihet në dispozicion kategorisë parësore dhe pjesa tjetër i shpërndahet kategorisë së trashëgimtarëve;
3. Dëmshpërblimi i plotë, për të gjithë ata ish-të dënuar, të cilët janë ende në jetë, por që për shkak të kufizimeve aktuale të kuadrit ligjor në fuqi, ku përcaktohet ndarja e shumës së dëmshpërblimit në 8 këste, me vlerë maksimale 1 000 000 lekë, nuk kanë marrë gjithë shumën e miratuar të dëmshpërblimit, ndërkohë që ekzistojnë subjekte parësore, të cilët e superojnë këtë vlerë (8 x 1 000 000 lekë);
4. Ky projektligji synon të trajtojë ato subjekte përfituese, vlera totale e miratuar për të cilët është deri në 1 000 000 lekë, duke krijuar mundësinë që të likuidohen në një këst të vetëm, pavarësisht fazës në të cilën ndodhet shpërndarja e dëmshpërblimit.

**RAPORTI I PAGESAVE**

1. Ndryshimin e raportit të përcaktuar të fondit të miratuar, ku 70% i vihet në dispozicion kategorisë parësore dhe pjesa tjetër i shpërndahet kategorisë së trashëgimtarëve;
2. Mundësinë e dëmshpërblimit të plotë, për të gjithë ata ish-të dënuar, të cilët janë ende në jetë, të cilët për shkak të parashikimeve aktuale ligjore ishin të kufizuar në marrjen e vlerës maksimale të dëmshpërblimit, pasi parashikimet ligjore e kufizonin ndarjen e shumave në 8 këste, me vlerë maksimale 1 000 000 (një milion) lekë. Ndërkohë që ekzistojnë subjekte parësore të cilët e superojnë këtë vlerë (8 x 1 000 000 lekë), të vendosur nga ligji;
3. Rishikimin e trajtimit të subjekteve përfituese, vlera totale e miratuar për të cilët është deri në 1 000 000 lekë, duke krijuar mundësinë e likuidimit në një këst të vetëm, pavarësisht fazës në të cilën ndodhet shpërndarja e dëmshpërblimit.

dhe të internuara. Ashtu sikurse ligjet e mëparshme amenduese të ligjit nr.9831, datë 2007, të ndryshuar, edhe ky projektligji synon përmbyljen e procesit të dëmsh-

përblimit për ata ish-të dënuar që kanë vuajtur vetë dënimin gjatë regjimit komunist, si dhe familjarëve të tyre, njëpër një gjetjes të mekanizmave eficientë.

## "Fundi i marrëzisë", Tabaku: Pastrim parash përmes lojërave të fatit

Një ditë pasi mazhoran e Ekonomisë vendosi t'i kërkojë parlamentit rrezimin e dekretit të Presidentit Ilir Meta, i cili sillte për rishqyrtim ligjin për tatin mbi të ardhurat, pasi, sipas tij, ulja e barrës fiskale për lojërat e fatit stimulonte këtë industri, duke krijuar efekte negative në aspektin social dhe ekonomik. Deputetja e Partisë Demokratike, Jordana Tabaku përmes një postimi në rrjetet sociale ka vënë në dukje se në 5 vitet e PS ndryshe nga sa u premtua, lojërat e fatit janë favorizuar. Për Tabakun, ulja e taksimit të pikave të bastit dhe lojërave të fatit nga 23% në 15%, vjen pasi qeveria "Rama", siç shumë e kanë të qartë është skllave e kriminit të organizuar dhe pastruesve të parave. "E



meqenëse djalli qëndron në detaje, shembulli më i qartë se pse sot qeveria, krimi, pronarët e lojërave të fatit janë një, është pastrimi i parave që shpëgon rritjen e numrit të pikave të bastit. Kjo nuk mund të kish ndodhur pa mbështetje, bashkëpunim e inkurajim nga niveli më i lartë, pra kryeministri Rama tek ai më i ulëti", shprehet ajo, teksa vë në dukje shtimin e pikave të

bastëve ndër vite. "Nga gjoja aksioni "Fund i marrëzisë" e deri më sot pikat e lojërave të fatit dhe bastëve sportive janë më shumë se shumëfishuar. Në kohën e qeverisë së 'keqe' Berisha ishin 928 ndërsa në kohën e qeverisë së 'mirë' Rama janë 4230, jo vetëm kaq, por pikat pranë institucioneve shkollore, fetare dhe shtetërore janë shtuar si kërpudha pas shiut". Më tej ajo rikujton premtimet e ministrit Ahmetaj, i cili sipas saj: "Sot ka veshur pelerinën e luftëtarit të paepur kundër kazinovave dhe bastëve sportive, por argumentonte se ishte por nismës së deputetëve të mazhorancës në Komisionin e Ekonomisë dhe Financës për shtyrjen e ligjit të lojërave të fatit. Siç e mbaj mend zotimin e tij për aktet nënligjore që do të vinin brenda viti 2017, por që nuk erdhën kurrë"

**REPUBLIKA E SHQIPËRISE**  
**BANKA E SHQIPËRISE**  
DEPARTAMENTI I ADMINISTRIMIT  
SEKTORI I PROKURIMIT

**TENDER I HAPUR KOMBËTAR**

Banka e Shqipërisë kërkon të realizojë objektin e prokurimit: "Shërbimi vjetor i mirëmbajtjes së sistemeve të kondicionimit në dhomat e serverëve dhe arkivës së Bankës së Shqipërisë"

"Banka e Shqipërisë fton kandidatët e interesuar, të marrin pjesë në procedurën e prokurimit "Tender i hapur kombëtar", për realizimin e objektit të prokurimit si më sipër, me **fond limit 1,388,000 Lekë**."

Dokumentet e tenderit mund të tërhiqen pranë Sektorit të Prokurimeve të Departamentit të Administrimit, të Bankës së Shqipërisë, me adresë: Rruga e Dibrës, Kompleksi "Hallit", Kulla A, Tiranë, Tel. 042419411 (ext. 4251), çdo ditë nga ora 10.00 – 13.00 nga çdo person i autorizuar, me paraqitjen e një kërkesë me shkrim. Tërheqja e dokumenteve mund të bëhet vetëm pasi të keni bërë paraparakisht pagesën e paktyshme prej 500 Lekë, pranë një banke tregtare në llogarinë e Bankës së Shqipërisë sipas detajeve të mëposhtme:

Përfituesi: Banka e Shqipërisë  
BIC: STANALTR  
IBAN: AL68 1011 1008 0000 0000 2222 222L; BIC

Përshkrimi: Blerje dokumente tenderi për tenderin me objekt: "Shërbimi vjetor i mirëmbajtjes së sistemeve të kondicionimit në dhomat e serverëve dhe arkivës së Bankës së Shqipërisë"

Oferta duhet të paraqitet në zyrën e Sektorit të Prokurimeve, pranë Departamentit të Administrimit, në Bankën e Shqipërisë, deri më **datë 05 Tetor 2018, ora 11:00**, kohë në të cilën do të hapet edhe tenderi, ku ftohen të marrin pjesë kandidatët ose përfaqësuesit e autorizuar të tyre.





## Përmbartimi Gjyqësor Shtetëror, akses 'online' në hartat e pasurive

Përmbartimi Gjyqësor Shtetëror do të ketë tashmë akses në regjistrin online të Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme. Kjo u arrit pas marrëveshjes që u nënshkrua mes krerëve të dy institucioneve, ndërsa zbatimi i saj pritet të shmangë vonesat dhe zvarritjet që shkaktoheshin më parë nga komunikimi mes zyrave me anë të shkresave. Përmbartimi Gjyqësor Shtetëror do të ketë akses në regjistrin elektronik të pasurive të paluajtshme, duke shmangur në këtë mënyrë shkresat burokratike dhe vonesat mes dy institucioneve. Dy krerët e këtyre zyrave thanë se kjo gjë do të shmangë vonesat shkresore, duke rritur shërbimet e qytetarëve. "Zyra qendrore e regjistrimit të pasurive nënshkruan këtë marrëveshje bashkëpunimi me

Përmbartimin Shtetëror dhe duke filluar nga dita e sotme Përmbartimi Shtetëror do të ketë akses online në regjistrin tanë hipotekor" tha kryeregjistruesi Valdrin Pietri. Nga ana e tij, Piro Lutaj, Drejtor i Përgjithshëm i Përmbartimit vlerësoi marrëveshjen e bashkëpunimit, pasi sipas tij shkurtohen procedurat dhe koha e dhënies së shërbimit nga ana e përmbartimit. "Përmes nën-

shkrimit të kësaj marrëveshjeje lehtësohen kontaktet me ZRPP në të gjithë territorin, pasi edhe zyrat përmbartimore në të gjithë territorin do të kryejnë më shpejt veprimet procedurale e ligjore për të përsheputur ekzekutimin e fitujve ekzekutivë. Pra, është një procedurë që u vjen në ndihmë qytetarëve të cilëve u shkurtohet koha e marrjes së shërbimit përmes këtij bashkëpunimi on line mes dy institucioneve"-u shpreh drejtori i Përgjithshëm i Përmbartimit.

Ndërtimet pa leje në Dibër, KLSH auditon ALUIZNI-n, gjen shkelje në 331 objekte

Ornela Manjani

Legalizimi i jash tëligjshëm i objekteve pranë rrugëve nacionale, në zona të mbrojtura, pranë brigjeve të lumenjve e përrënjeve, janë bërë shkak për kallëzimin penal të dy ish drejtorëve dhe një hartograf të degës së ALUIZNI-t në Dibër. Shkeljet janë evidentuar nga Kontrolli i Lartë i Shtetit, i cili ka audituar punën e aktivitetit të ALUIZNI-it Dibër për periudhën janar 2015 deri më 30 prill 2018. Përmes një deklaratë zyrtare KLSH bëri me dije se zyrtarët kanë kualifikuar 331 objekte, por nuk kanë kryer procedurat përkatëse duke i vonuar nga 1-3 vjet. Kanë kryer legalizime në Zonat e Mbrojtura pa leje mjedisore, kanë legalizuar objekte në afërsi të lumit Mat, kanë legalizuar objekte mbi objektet shtetërore me një dëm ekonomik në vlerën 80,7 milionë lekë. Po ashtu, mësohet se zyrtarët e ALUIZNI-t Dibër kanë legalizuar truall mbi trefishin pa zbatuar çmimin e tregut të caktuar me VKM me dëm ekonomik në vlerë 6,6 milionë lekë, ndërkohë që kanë shmangur procedurat ligjore për vërtetimin për likuidimin e takës së ndikimit në infrastrukturë, duke krijuar një mungesë të ardhurash në buxhetin e shtetit në vlerën 288,2 milionë lekë.

# Legalizime pranë rrugëve e lumenjve, dy ish-drejtorë në prokurori

Dëmi që i është shkaktuar buxhetit arrin në 80,7 milionë lekë



er legalizime të pasurive "Ndërtesë" dhe statutet juridikë të pasurive të legalizuara të dërguara me shkresë përcjellëse nga ZVRPP-të Mat, Peshkopi, Bulqizë, konfir-

mojnë pronësinë e truallit dhe ndërtimit (objektit) të legalizuar dhe janë pronë "Shtet" ose "Pronar i pavërtetuar". Në dosjet e audituara nuk u gjetën deklaratat materiale për prishje

**ZONA E MBROJTURA**  
Në 11 raste, si Zona e Mbrojtur Korab dhe Zona e Mbrojtur e Liqenit të Ulzës dhe Koritnik janë legalizuar objekte që ndodhen brenda zonave të mbrojtura pa u pajisur më parë me leje mjedisore nga autoritetet përkatëse.

njësisë administruese vendore e qendrore, si dhe të njësisive apo institucioneve shtetërore të cilët i kanë këto pasuri në administrim apo pronësi. Vlera prej 74,207 mijë lekë, e cila përfaqëson vlerën e llogaritur të sipërfaqes ndërtimore pronë "Shtet" dhe "Pronar i pavërtetuar" të legalizuar, është dëm ekonomik shkaktuar buxhetit të shtetit dhe është përveçësuar jashtia publike në rrugë ligjore. Për 527 objekte, kanë lëshuar leje legalizimi për objekte, pronarët e të cilave kanë përfituar një sipërfaqe totale 130816m2, ndërkohë që duhet të likuidonin për parcelën ndërtimore vlerën 261,631,800 lekë (lekë + bono privatizimi). Kjo ka ardhur në mungesë të VKM-ve, pasi për 491 objekte, DR e ALUIZNI-t qarku Dibër nuk ka përcjellë

shkresat për përgatitjen e VKM-ve dhe në dosjet e audituara nuk gjendet asnjë lloj dokumenti mbi arsyet e vonesave të shkresave për secilin objekt për mos dërgimin e shkresave në Drejtorinë e Përgjithshme të ALUIZNI-t Tiranë, e cila do ketë efekte negative në të ardhurat në buxhetin e shtetit"-thuhet në raport. Sipas KLSH-së Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Dibër ka marrë vendime "Për kualifikimin për legalizim të objektit informal", në kushtet kur në dosje mungojnë vërtetimet për likuidimin e takës së ndikimit në infrastrukturë, duke krijuar një mungesë të ardhurash në buxhetin e shtetit në vlerën 26,517,252lekë nga 795 objekte.

**RAPORTI**

Kontrolli i Lartë i Shtetit ka audituar Drejtorinë Rajonale të ALUIZNI-t qarku Dibër për periudhën 1 janar 2015 deri më 30 prill 2018. Nga ky auditim, u konstatuan shkelje të dispozitave ligjore për të cilat KLSH i ka përcjellë ALUIZNI-T Dibër gjetjet dhe rekomandimet përfundimtare të vendimit nr. 93, datë 29.07.2018 të Kryetarit të KLSH -se, si dhe ka përcjellë kallëzimin penal në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Dibër për SH.T dhe N.K ish Drejtorë, F.R Hartograf dhe V.GJ juriste të Drejtorisë Rajonale të ALUIZNI-t qarku Dibër. "Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t, qarku Dibër nuk ka ndjekur procedurat ligjore për 331 dosjet e dala nga arkiva të kualifikuara, duke shkelur afatet ligjore për shqyrtimin administrativ për legalizim, duke krijuar ndikime negative tek qytetarët. Në 32 raste, për sipërfaqen e përgjithshme ndërtimore 1335m2, janë kry-

**Raporti i Institutit të Statistikave**

## Papunësia zbrit në 12.4, por punësimi nuk është rritur



Shkalla e papunësisë ra sërish lehtë në tremujorin e dytë të vitit, duke vendosur një rekord të ri në ulje. Sipas Institutit të Statistikave, papunësia ishte 12.4%, nga 12.5% që kishte qenë tremujorin e mëparshëm. Krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë, shkalla e papunësisë në ekonominë shqiptare ka rënë me 1.5 pikë përqindjeje. Shifrat e papunësisë duken edhe tepër pozitive, po të kemi parasysh se rritja ekonomike është akoma nën potencialin e vet. Papunësia nuk ishte kaq e ulët as në vitet kur ekonomia shqiptare rritej gati dy

herë më shumë. Përtej debatteve mbi saktësinë statistikore, një hipotezë mund të jetë fakti se ekonomia shqiptare shfrytëzon së shumti faktorin punë, përkundrajt një shkalle më

të ulët të shfrytëzimit të inovacionit dhe teknologjisë në proceset e prodhimit. Të paktën për tremujorin e dytë, ulja e papunësisë nuk u shoqërua me rritje të shkallës së punësimit, që nge-

lin në nivelin 59.2%. Nëse shkalla e papunësisë mat numrin e të papunëve kundrejt forcës totale të punës, shkalla e punësimit jep raportin mes numrit të të punësuarve dhe popullsisë në moshë pune. Një ulje e papunësisë në ekonomi jo domosdoshmërisht shoqërohet me rritje të shkallës së punësimit. Shkalla e papunësisë mund të ndikohet edhe nga luhatjet në forcën e punës dhe në popullsinë ekonomike aktive. Këtu përfshihen edhe të dekurajuarit. Sipas INSTAT, 8.1% e shqiptarëve në moshë pune nuk kërkojnë

punë pasi kanë humbur besimin se mund ta gjejnë atë. Në përgjithësi, Shqipëria vazhdon të ketë një pjesëmarrje të popullsisë në forcën e punës, sidomos mes grave. Vetëm 51.4% e grave mbi moshën 15 vjeç janë të punësuar ose në kërkim të një pune. Nga ana tjetër, gratë kanë edhe shkallën më të ulët të papunësisë, me 11.8%, ndërsa të meshkujt ky tregues është 12.9%. Pjesërisht, kjo mund të shpjegohet edhe me faktin se pjesëmarrja e grave në tregun e punës është modeste. Një tjetër zhvillim për t'u përmendur në tremujorin II është rënia e mëtejshme e papunësisë mes të rinjve, që ka zbritur në 22.6%, niveli më i ulët historik.

Të akuzuar për një serë krimesh, arrestohen 7 persona

# Drogë dhe gjoba bizneseve, shkatërrohet grupi mafioz italo-shqiptar

Në kuadër të një operacioni të zhvilluar nga policia italiane, janë vënë në pranga 7 persona. Grupi i rrezikshëm kriminal italo-shqiptarë merreshim me trafik droge, kërcënime dhe zhvatje me dhunë, kryesisht ndaj sipërmarrësve në provincën e Bergamos. Policia lokale nuk jep emrat, por thotë se ata ishin kthyer në merrin e bizneseve të zonës pasi me anë të shantazhit ata dhunonin e kërcënonin tregtarët në rast se nuk paguanin gjobën. Në rast se paguanin aktiviteti i tyre ishte i mbrjotur. Emrat e të arrestuarve nuk bëhen të ditur pasi operacioni është në vijim. Ndaj tyre do të ngrihet akuzë e organizimit të një grupi mafioz.

## OPERACIONI

Operacioni është zhvilluar nga Guardia Di Finanza e Bergamos mëngjesin e 11 shtatorit, ku në pranga janë vënë 7 anëtarë të këtij grupi të rrezikshëm, shqiptarë dhe italianë, identiteti i të cilëve nuk bëhet ende i ditur. 6 anëtarë të tjerë të grupit, siç bëjnë me dije mediat italiane, janë arrestuar më herët. Të 13 anëtarët e grupit të shkatërruar veprom në koordinim me njëri-tjetrin. Sipas burimeve policore grupi funksiononte me rregullë të forta dhe detyra të ndara. Mediat italiane shkruajnë se shqiptarët e arrestuar përgjigjeshin për trafikun e drogës dhe të klandestinëve. Hetuesit thanë se ky ishte një grup mjaft i rrezikshëm. Mediat italiane flasin për hetime të gjata, komplekse dhe me rrezikshmëri të lartë, madje një prej oficerëve të policisë ka rrezikuar të vritet nga ana e këtij grupi. Por në përfundim të hetimeve është arritur të dokumentohen me filmime rastet e shumta të kërcënimeve dhe dhunës mbi pronarët e bizneseve në provincën e Bergamos, si dhe përgjime dhe ndjekje në terren. Në një rast madje pronari i një lokali në komunën Cognola ishte detyruar të paguante 5 mijë euro gjobë që të siguronte ruajtjen e biznesit të tij. Agjentët kanë ndjekur edhe një tentativë vrasjeje, që dështoi për shkak se autorit iu bllokua arma. Policia thotë se ka sekuestruar 4 armë zjarri, mes tyre edhe silenciator me numër serie



## HETIMET

Në përfundim të hetimeve është arritur të dokumentohen me filmime rastet e shumta të kërcënimeve dhe dhunës mbi pronarët e bizneseve në provincën e Bergamos, si dhe përgjime dhe ndjekje në terren.


### HETIMET

Grupi funksiononte me rregullë të forta dhe detyra të ndara. Mediat italiane shkruajnë se shqiptarët e arrestuar përgjigjeshin për trafikun e drogës dhe të klandestinëve. Hetuesit thanë se ky ishte një grup mjaft i rrezikshëm. Mediat italiane flasin për hetime të gjata, komplekse dhe me rrezikshmëri të lartë, madje një prej oficerëve të policisë ka rrezikuar të vritet nga ana e këtij grupi.



të fshirë, municione, fisheکہ dhe para cash. Ndëkohë dy ditë më parë në një tjetër

operacion antidrogë të zhvilluar në tre shtete, Itali, Gjermani dhe në Shqipëri përfunduan në pranga 20 persona, mes të cilëve 18 janë shqiptarë, një shtetas kosovar dhe një pakistanez. Gjatë operacionit kundër trafikut të drogës nga Europa e veriut drejt Italisë u sekuestrua 120 kilogram drogë mes të cilës kokainë, heroinë dhe marijuanë. Droga e sekuestruar kapte vlerën mbi 20 milionë euro. Operacioni i quajtur "Alba Bianca" u krye në Trentino-Alto Adige, Lombardi dhe Veneto. Trafikantët që kanë përfunduar në pranga bënë pjesë në dy grupet "Baruti" dhe "Bushi". Sipas hetuesve, grupi "Baruti" përbëhej nga 13 anëtarë: Florjan Musaj, Eduart Gona, Artur Muca, Eljon Baruti, Keti Shani, Klevis Kodra, Artan Sokola, Shafique Mohammad Amar, Rajmond Prenga, Ben Jale Aziza Omar, Erion Alla, Halil Alla. Grupi "Bushi" përbëhej nga 7 anëtarë: Vaskë Xherahu, Hamit Bushi, Arben Lleshi, Odeon Proko, Blerina Cela, Manfred Hophensberger, Qerim Lumi. Ata merreshin me trafik heroinë, kokainë dhe marijuanë.



Implemented by **giz** Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH

Field of Activity

The Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit GmbH (GIZ) is a federal enterprise that supports the German Government in achieving its objectives in the field of international cooperation for sustainable development.

**Open Regional Fund Modernisation of municipal services (ORF MMS)**  
 The Open Regional Funds for South-East Europe have been established on behalf of the German Federal Ministry for Economic Cooperation and Development (BMZ) with the aim to build capacities and to support EU integration of the South-East European countries through regional projects.  
 These countries are facing great challenges due to decentralization, especially in the field of municipal services. Municipalities and public utilities often lack capacities and products necessary for implementing the EU's demanding standards, which require to improve the quality of municipal services. In order to meet these challenges, the Open Regional Fund for South-East Europe – Modernisation of Municipal Services (ORF MMS) strengthens the capacities of regional networks such as the Network of Associations of Local Authorities in South-East Europe (NALAS) to achieve cooperation between the members within the network as well as with other networks in order to effectively provide the users of municipal services with high quality and efficient service.  
 The Open Regional Fund for South-East Europe – Modernisation of Municipal Services has established itself as a relevant cooperation and networking platform for all regional stakeholders interested in improving municipal services in South-East Europe.

**Open Regional Funds for South-East Europe – Implementation of the Convention on Biological Diversity (ORF BDU) in the Western Balkans**  
 The Western Balkans region (Albania, Bosnia and Herzegovina, Kosovo, Macedonia, Monte-negro and Serbia) is exceptionally rich in terms of biodiversity and harbours a large variety of ecosystems that range from Mediterranean coastal areas, over rivers, forests and steppes to high alpine mountain regions. The Western Balkans therefore plays a crucial role in the conservation of biodiversity in Europe. Western Balkans countries have committed themselves to biodiversity conservation in the framework of international agreements on biodiversity conservation, most of them signed and ratified, in particular the 2030 Agenda, the UN Biodiversity Convention (CBD), the Bern Convention on the Conservation of Wildlife and Natural Habitats, the Convention on International Trade in Endangered Species of Wild Fauna and Flora (CITES), the International Convention on the Protection of the Cultural and Natural Heritage of the World drawn up by UNESCO, the Convention on Wetlands of International Importance especially as Waterfowl Habitat (the Ramsar Convention) and the UN Framework Convention on Climate Change.

The goal of the TC module is strengthening the regional cooperation between the countries of the Western Balkans regarding the fulfilment of international obligations for the preservation of biodiversity, and EU-related obligations under the environmental acquis communautaire in particular.

The project aims to 1) improve the performance of functions of regional structures created by its predecessor as interest groups for advocating biodiversity conservation in the EU integration process and institutions, namely the Biodiversity Task Force established under the Regional Cooperation Council (RCC), regional scientific platform and NGO network as well as local coordination structure of a cross-border conservation area, 2) improve the regional exchange of information on biodiversity conservation between public sector, scientific and civil society actors, and 3) better incorporate the assessment of ecosystem services as an instrument of public development planning in the region in educational institutions for public administration.

GIZ Office to Albania seeks the following staff: **Office Manager**

**A. Sphere of responsibility**

The office manager is responsible for the:

- ensuring efficient day-to-day running of the project offices (ORF BDU and ORF MMS)
- acting as focal point for both projects on administration and finances including contracting as needed;
- providing administrative, organizational and logistical services to the project management and teams;
- managing project data and file management system in DMS in line with GIZ's filing rules;
- ensuring good flow of communication and information within the projects and with the GIZ office in Tirana.

**The Office manager performs the following tasks:**

**B. Tasks**

**1. Secretariat work and services**  
 The office manager

- organizes and coordinates project activity schedules as requested by each project representative;
- prepares and organizes information materials for the ORF project representatives and – or meetings;
- manages incoming and outgoing correspondence and prioritizes and organizes it;
- replies and looks after correspondence;
- Participates in internal and external meetings and workshops and assists with documenting these (minutes);
- ensures that the necessary office supplies are available;
- purchases office equipment and supplies within set value limits and procurement rules;
- reports damage to the project officer, organizes and monitors the service and repair of office equipment.

**2. Office coordination, office management and coordination**  
 The office manager

- deals with external contacts;
- coordinates and organizes rooms for meetings and catering;
- coordinates travel arrangements of team, partner and experts as needed;
- coordinates equipment for meetings;
- photocopies and scans documents as needed;
- supports the preparation and submission of VAT reimbursement documents to respective Ministries;
- in charge of office inventory including regular update of list;
- responds on requests from ORF management team in Sarajevo;
- interprets and translates as needed and possible upon request.

**3. Other duties/additional tasks**  
 The office manager

- performs other duties and tasks at the request of management and ORF representatives

**C. Qualifications, skills and experience required**

**Qualifications:**

- university degree in relevant qualification: Finance and/or Business; Management/Administration equivalent of BA or MSc;
- at least 3 years professional experience in a similar position;
- experience in office and programme management, particularly within international organizations;
- ability to support a multi-task, multi-discipline international programme team;
- excellent working knowledge of MS products, particularly Word, Excel and PowerPoint;
- fluency in written and spoken Albanian and English, German language would be an asset;
- able to work in a team as well as independently;
- excellent social and communications skills.

**Contract conditions:**

- Full time employment, 50% ORF MMS and 50% ORF BDU;
- Programme office in Tirana with few travels in the region;
- Assignment period: one year

Please forward your application until **19th of September 2018**, to GIZ Office Albania by E-Mail: [giz-albanien-hr@giz.de](mailto:giz-albanien-hr@giz.de), including the following information: Application letter, CV in English (Euro Pass format), references.

Only short-listed candidates will be contacted for interviews. Short-listed candidates will be asked to bring certified copies of their diplomas and work certificates.

**GIZ is an equal opportunity employer and welcomes applications from all interested groups without any discrimination!**



Caktohet seanca e radhës, më 25 shtator pritet të lexohen konkluzionet

# Shtyhet pretenca për Emiljano Shullazin, Hajdarmataj do kohë të njihet me dosjen

## Avokati: Hetimi u fillua pa prova, të dorëhiqet prokurori

Gjykata e Krimeve të Rënda ka shtyrë ditën e djeshme presencën për Emiljano Shullazin dhe katër të pandehurit e tjerë të bandës së tij, të akuzuar për gjobëvënie, grup të strukturuar kriminal dhe kanosje për shkak të detyrës. Ish-drejtuasi i Prokurorisë së Krimeve të Rënda u kërkoi kohë togave të zeza që të njihet me dosjen, çka u bë shkak për shtyrjen e seancës. Seanca gjyqësore u shty me datë 25 shtator.

Organi i akuzës nuk arriti të lexojë konkluzionet për këtë grup, për shkak të mungesës së dy prokurorëve që drejtuan hetimet, Elizabeta Imeraj dhe Ened Nakuçi. Ky u fundit nuk ishte në sallë për arsye shëndetësore, ndërsa vendin e Imerajt e kishte zënë Besim Hajdarmataj. Ndërkohë seanca gjyqësore u shoqërua me debate të ashpra mes avokatëve mbrojtës të Emiljano Shullazit e bandës së tij dhe prokurorit Hajdarmataj.

### SEANCA GJYQËSORE

Avokatët e të pandehurve kërkuan përjashtimin e prokurorit Besim Hajdarmataj, të cilin e kanë akuzuar përgjatë gjithë procesit për ndërhyrje të paligjshme në proces dhe për një takim me biznesmenin Ylvi Beqja, që mban statusin e bashkëpunëtorit të drejtësisë dhe dëshmia e tij konsiderohet si prova kyçe në proces. Në nisje të seancës, Hajdarmataj deklaroi në sallën e gjyqit se nuk ka asnjë konflikt interesi për të përfaqësuar akuzën ndaj pesë të pandehurve, por duke qenë se është njohur me autorizimin e drejtueses se re të prokurorisë Donika Praela, me datë 10 shtator, pra një ditë përpara seancës, i duhet të studiojë fashikujt dhe të përpilojë pretendencën. Mësohet se avokatët shpërthyen në akuzë ndaj njeriut që më herët e patën kërkuar si dëshmitar në proces. Hajdarmataj u kundërpërgjigj, duke u kujtuar mbrojtësve ligjore, se në cilësinë e drejtuesit të prokurorisë, nuk ka patur prej tyre asnjë pretendim lidhur me çfarë u aludua në seancë. Përballja mes palëve u zhvillua në mungesë të Shullazit dhe të pandehurve të tjerë, të cilët kishin vendosur të bojkotimin seancën. Ajo që ra në sy ishte fakti, se si asnjëherë më parë, seanca u zhvillua nën masa të rrepta sigurie. Arsyet përse gjykata u blindua, nuk u bënë të ditura. Në fund të procesit, që u shty me datë 25 shtator, avokati Vladimir Meci akuzoi prokurorinë se ka dështuar në përpjekjet e saj për të provuar akuzat ndaj të pandehurve. "Fillimi i këtij procedimi është i paligjshëm. Është filluar hetimi pa prova. Ka paligjshmëri të kryera nga organi i akuzës duke filluar nga momenti i arrestit", tha avoka-



Emiljano Shullazi

### Akuza

**AVOKATI**

Në fund të procesit, që u shty me datë 25 shtator, avokati Vladimir Meci akuzoi prokurorinë se ka dështuar në përpjekjet e saj për të provuar akuzat ndaj të pandehurve. "Fillimi i këtij procedimi është i paligjshëm. Është filluar hetimi pa prova. Ka paligjshmëri të kryera nga organi i akuzës duke filluar nga momenti i arrestit", tha avokati.

ti. Ndërkohë të pandehurit Emiljano Shullazi, Blerim Shullazi, Gilmando Dani, Endrit Qyja dhe Endrit Zela nuk ishin të pranishëm në seancë. Banda e Shullazit akuzohet për krijimin e grupit të strukturuar kriminal, kanosje për shkak të



AVOKATI

detyrës ndaj Mynyr Konit e Dhori Kules dhe shtërëngim me anë të kanosjes për dhënie pasurie kundër Ylvi Beqes për ish-hotel "Vollgën" në Durrës. Shullazi rrezikon deri në 15 vite burg për akuzat, po ashtu edhe anëtarët e bandës.

### Shtyhet seanca për Bledar Jambellin dhe Shpëtim Lecin

## Vrasja e Artan Cukut, policia e Fierit dhe Beratit nuk japin informacion për të kërkuarit

Gjykata e Krimeve të Rënda ka shtyrë ditën e djeshme seancën e parë gjyqësore ndaj Bledar Jambellit dhe Shpëtim Lecit të akuzuar për vrasjen e komisar Artan Cukut. Të dy personat e sipërpërmendur po gjykohehen në mungesë, pasi janë shpallur në kërkim nga drejtësia.



### SEANCA

Krimet e Rënda kanë urdhëruar policinë e Beratit dhe Fierit të bëjnë kërkime dhe të njoftojnë të pandehurit. Pikërisht mungesa e përgjigjeve nga këto institucione, nëse i kanë njoftuar apo i kanë gjetur dy personat e shpallur në kërkim u bë shkak i shtyrjes së seancës.

tëpinë e tij në Tiranë natën e 8 prillit të vitit 2017. Ai u qëllua me 5 plumba, katër në gjoks dhe një në kokë. Për vrasjen e Cukut gjykata ka dënuar me 10 vite heqje lirie Mikel Shallarin, pasi mban statusin e bashkëpunëtorit të policisë, sepse tregoi emrat që urdhëruan krimin. Bledar Jambelli akuzohet si urdhërues i vrasjes së Artan Cukut, ndërsa Leci si ndërmjetës. Ky i fundit është kushëri me ekzekutuesin real, Mikel Shallari. Kryekomisari u vra duke hyrë në shtëpinë e tij në Tiranë natën e 8 prillit të vitit 2017. Ai u qëllua me 5 plumba, katër në

gjoks dhe një në kokë. Për vrasjen e Cukut gjykata ka dënuar me 10 vite heqje lirie Mikel Shallarin, i cili bashkëpunoi me drejtësinë dhe tregoi emrat që urdhëruan krimin. Emri i porositesit të vrasjes së ish-komisarit Artan Cuku u zbulua rreth një vit pas ekzekutimit të tij. Personi, i cili kontraktoi Mikel Shallarin, për ekzekutimin e Cukut, dyshohet të jetë 37-vjeçari Bledar Jambelli. Ai është shpallur në kërkim ndërkombëtar me vendim të Gjykatës për Krime të Rënda, e cila ka caktuar për të masën e arrestit me burg.



## Aksidentet rrugore, policia: Më mirë gjoja e hidhur se parakalim i gabuar fatal

Vijojnë mesazhet sensibiliizuese nga policia e shtetit lidhur me drejtuesit e mjeteve. Nëpërmjet një postimi në rrjetin social 'Facebook', policia i kërkoi drejtuesve të mjetit të respektojnë Kodin Rrugor, me qëllim shmangien e aksidenteve, të cilat mund të rezultojnë fatale për jetën e tyre. "Kur nuk respektohet minimalisht çfarë ligji kërkohet - dispozita e "parakalimit", ndodhin ngjarje aksidentale tragjike... Prandaj Policia Rrugore insiston veçanërisht në respektimin e kësaj dispozite. Rrugët në Shqipëri janë në shumicën e tyre me

drejtuesit e mjeteve ku i kërkohet të respektojnë Kodin Rrugor, me qëllim shmangien e aksidenteve, të cilat mund të rezultojnë fatale për jetën e tyre. "Kur nuk respektohet minimalisht çfarë ligji kërkohet - dispozita e "parakalimit", ndodhin ngjarje aksidentale tragjike... Prandaj Policia Rrugore insiston veçanërisht në respektimin e kësaj dispozite. Rrugët në Shqipëri janë në shumicën e tyre me

sens qarkullimi të alternuar prandaj duhet bërë kujdes... më mirë një gjobë e "hidhur dhe gjallë" sesa një parakalim i gabuar fatal dhe... "i fundit"! Drejtuesi i mjetit: nuk është e nevojshme të ngrini sytë në qiell për të parë ku është droni i Policisë Rrugore, mjafton të ngrini sytë deri tek tabela vertikale që paralajmëron "ndalimin e parakalimit"...", thuhet në njoftimin e Policisë së Shtetit.

**50% e nxënësve nuk ndihen të sigurt në shkollë**

**Raporti, rreth 70% e fëmijëve kanë qenë viktima të dhunës të paktën një herë**

Gjatë vitit 2016-2017, rreth 70% e fëmijëve në vendin tonë kanë përjetuar një formë dhune, ndërkohë që 50% e nxënësve kanë pohuar se nuk ndihen të sigurt në shkollë. Këto të dhëna zbardhen nga raporti më i fundit i organizatës World Vision, e cila operon edhe në Shqipëri. "Dhuna fizike dhe ajo psikologjike janë format më të përhapura të dhunës ndaj fëmijëve. Po ashtu, 80% e prindërve ose kujdestarëve raportojnë se kanë përdorur dhunë të paktën një herë gjatë vitit si mjet disiplinimi dhe 39.7% e prindërve raportojnë se i kanë neglizhuar në ndonjë mënyrë fëmijët e tyre. Gjithashtu, shqetësimet e tyre. Gjithashtu, shqetë-

**RAPORTI**

"80% e prindërve ose kujdestarëve raportojnë se kanë përdorur dhunë të paktën një herë gjatë vitit si mjet disiplinimi dhe 39.7% e prindërve raportojnë se i kanë neglizhuar në ndonjë mënyrë fëmijët e tyre. Gjithashtu, shqetësimet e tyre. Gjithashtu, shqetë-

suese paraqiten edhe të dhënat për nivelin e dhunës në shkollë. 50% e fëmijëve raportojnë se nuk ndihen të sigurt në ambientet e shkollës", theksohet në raport. Ndërkohë dhuna në

të gjitha format e saj, po dëmton çdo ditë jetën e fëmijëve dhe të rinjve në Shqipëri. Festivali i Rinisë për Drejtësi Sociale, që organizohet për të dytin vit radhazi nga World Vision syn-

on të nxisë ndryshimin e sjelljeve dhe qëndrimeve, lidhur me dhunën ndaj fëmijëve dhe të rinjve, në mënyrë që ata të mund të rriten në komunitete të sigurt dhe gjithëpërfshirëse.

Ditën e djeshme, të rinjtë kanë treguar përmes dëshmimeve jo vetëm vështirësitë me të cilat ata përballen, në familje, shkollë apo në komunitete, por edhe sesi ata ia kanë dalë që t'i kalojnë situatat.

Që prej vitit 1999, World Vision kontribuon në të



Foto ilustruese

gjithë Shqipërinë me programet e saj në drejtim të reduktimit të dhunës, sidomos dhunës ndaj fëmijëve në familje, komunitet, shkollë dhe mes bashkëmoshatarëve për të përmirësuar

politikat shtetërore për fëmijët, për të rritur pjesëmarrjen e fëmijëve në vendimmarrje, fuqizimin e fëmijëve dhe të rinjve, si dhe përmirësimin e mekanizmave dhe të shërbimeve për fëmijët.

Kryebashkiaku i Tiranës: Do të ndërtojmë 17 shkolla të reja, fund mësimi me dy turne

**Nga 17 shtatori, kufizohet orari për qarkullimin e mjeteve furnizuese**

*Veliaj: Të mos pengojmë nxënësit e shkollave*

Voltiza Duro

Nga data 17 shtator, me fillimin e vitit të ri shkollor, rikthehet edhe kufizimi i qarkullimit për mjetet që kryejnë furnizimin e dyqaneve. Ky kufizim për këto automjete do të bëhet nga ora 7 deri në 9 të mëngjesit. Kjo masë e Bashkisë së Tiranës ka për qëllim të ulë fluksin e trafikut në orët kur nxënësit e Tiranës shkojnë në shkollë, si dhe synon që fëmijët të mos humbin orën e parë të mësimi.

Kryebashkiaku Erion Veliaj, gjatë takimit me drejtorët e shkollave 9-vjeçare dhe të mesme, theksoi se kjo masë ndërmerret për t'i ardhur në ndihmë prindërve dhe nxënësve, që ata të mbërrijnë në kohë në shkollë duke pasur një fluks më të ulët trafiku. "Do të rifusim në veprim regjimin e ri të trafikut, me orare për të shmangur qarkullimin e kamionëve dhe furgonëve në kohën kur nxënësit shkojnë në shkollë; po ashtu, edhe institucionet të mos shkojnë të gjitha në orën 8:00 në punë. E kam thënë, nuk mund të vlejë patatinat dhe çamçakizat, më shumë se fëmijët. Të shkojnë njëherë fëmijët në shkolla, pastaj furgonët mund të bëjnë dërgesat e tyre, para orës 7.00 ose pas orës 9.00, që të mos kemi kaos në trafik", theksoi Veliaj.

**MËSIMI ME DY TURNE**  
Kryebashkiaku i Tiranës u ndal edhe në investimet e bëra për infrastrukturën arsimore duke theksuar se do t'i jepet fund mësimi me dy turne falë ndërtimit të shkollave të reja si edhe shtimit në kapacitetet të atyre ekzistuese. "Unë besoj se



Kryebashkiaku Erion Veliaj, gjatë takimit me drejtorët e shkollave 9-vjeçare dhe të mesme

**"TË MOS KRIJOHET TRAFIK"**

"E kam thënë, nuk mund të vlejë patatinat dhe çamçakëzët më shumë se fëmijët. Të shkojnë njëherë fëmijët në shkolla, pastaj furgonët mund të bëjnë dërgesat e tyre, para orës 7.00 ose pas orës 9.00, që të mos kemi kaos në trafik", - theksoi Veliaj.

vitin tjetër, jo vetëm mbarojnë këto që janë në proces, por brenda muajit shtator do të fillojmë themelet e para të 17 shkollave të reja. Kam përshtypjen se keni dijeni ku do të jenë shkollat e reja, pasi u kemi dhënë një fokus të madh shkollave peri-urbane, sepse ato dyndin zonën e Tiranës së vjetër. Me 17 shkollat e reja që presim të hedhim themelet, shtatori tjetër të na gjejë me një pjesë të kompletuar, minimalisht nuk do flasim më për klasat me dy turne", u shpreh kryebashkiaku në mbledhjen

me drejtuesit e shkollave. Më tej ai foli edhe për çështjen e klasave kolektive, duke nënvizuar se Bashkia e Tiranës është gati të subvencionojë transportin e nxënësve për të zhvilluar mësim në shkolla të rregullta.



**SHKOLLA TË REJA**

"Brenda muajit shtator do të fillojmë themelet e para të 17 shkollave të reja. Me 17 shkollat e reja që presim të hedhim themelet, shtatori tjetër të na gjejë me një pjesë të kompletuar, minimalisht nuk do flasim më për klasat me dy turne", - u shpreh kryebashkiaku.

Përmbaruesi Gjyqësor Privat Z. Medar Kajolli, njofton shpalljen për shitje në ankand të Tretë për pasuritë e paluajtshme si më poshtë;  
- Pasuria Nr. 250/3+1-2, Vol.-31, Iq.-234, Z.K-1791, Apartament me Sip.-209.7 m2, në vlerën 4756'000 (Kaltër milion e shtatëqind e pesëdhjetë e gjashtë mijë) Lekë.  
- Pasuria Nr. 250/3+1-3, Vol.-31, Iq.-235, Z.K-1791, Apartament me Sip.-209.7 m2, në vlerën 4756'000 (Kaltër milion e shtatëqind e pesëdhjetë e gjashtë mijë) Lekë.  
- Pasuria Nr. 211/11, Vol.-4, Iq.-201, Z.K-1791, IlojAve me Sip.-500 m2, në vlerën 252'000 (Dyqind e pesëdhjetë e dy mijë) Lekë.  
Ankand për pasuritë e mësipërme zhvillohet në datë 03.10.2018, në orën 16.00, në ambientet e zyrës së Përmbaruesit Gjyqësor Privat Z. Medar Kajolli, me adresë: Rruga "Urani Pano", Pll.-1/3, Kati -2, Tiranë. Cel. 069 73 23 003, email: medar.kajolli@yahoo.com



Nikolla: Vëmendja të nxënësit

**AKU, inspektim bizneseve pranë shkollave**

Një vëmendje të veçantë këtë vit do të ketë edhe siguria ushqimore ndaj nxënësve. Inspektorët e Agjencisë Kombëtare të Ushqimit kanë filluar punën në terren për të kontrolluar bizneset që ushtrojnë aktivitetin e tyre pranë institucioneve shkollore. Në inspektimin e disa subjekteve në qytetin e Lezhës ishte e pranishme edhe ministrja e Arsimit, e shoqëruar nga zëvendësministrja e Buqësisë dhe kreu i Agjencisë Kombëtare të Ushqimit, të cilët pas inspektimit komunikuan me administruesit e disa bizneseve duke u kërkuar respektimin e kushteve sipas rregullave në fuqi dhe të tregojnë kujdes maksimal ndaj produkteve që tregtojnë, pasi diskutohet shëndeti i fëmijëve që është prioritet me rëndësi për prindërit, por edhe institucionet që ushtrojnë kontrollin. "Shkolla po fillojnë dhe gjithë vëmendja është tek nxënësit edhe në një aspekt tjetër që lidhet me sigurinë ushqimore. Ndaj në cilësinë e ministres do doja të falënderoja Autoritetin Kombëtar të Ushqimit, të cilët këto ditë përfundojnë inspektimet e para të gjithë standardeve të bizneseve që operojnë rrotull shkollave. Do të jetë një vëmendje e posaçme edhe në ditët kur fillojnë shkolla në mënyrë që ne të kemi sigurinë ushqimore për të gjithë gamën e asortimenteve që këto biznese ofrojnë për nxënësit dhe jo vetëm", -tha Nikolla.

**SYNIMI**  
Ky kufizim për këto automjete do të bëhet nga ora 7 deri në 9 të mëngjesit. Kjo masë e Bashkisë së Tiranës ka për qëllim të ulë fluksin e trafikut në orët kur nxënësit e Tiranës shkojnë në shkollë, si dhe synon që fëmijët të mos humbin orën e parë të mësimi.



# RRITJA E PENSIONEVE VENDIMI

Voltiza Duro

**P**rejt datës 1 shtator të këtij viti, do të zbatohet rritja e pensioneve për të gjithë invalidët paraplegjikë, tetraplegjikë si dhe të verbrit. "Gazeta Shqiptare" zbardh ditën e sotme vendimin e Këshillit të Ministrave ku tregohet konkretisht rritja përkatëse e pensioneve për kategori të sipërpërmendura. Respektivisht sipas vendimit, masa e përfitimit për invalidët paraplegjikë dhe tetraplegjikë, do të bëhet 10.540 lekë në muaj, nga 10.330 lekë që ishte deri në gusht. Ndërkohë kujdestari i këtyre personave do të marrë një pension prej 11.070 lekësh në muaj, nga 11.500 lekë që ishte më parë. "Masa e përfitimit të aftësisë së kufizuar, të përcaktuar në pikën 8, të VKM-së nr. 618, datë 7.9.2006, bëhet 10.540 (dhjetë mijë e pesëqind e dyzet) lekë në muaj për personat e përcaktuar në pikën 1 të vendimit. Të njëjten masë përfiton edhe kujdestari i personit me aftësi të kufizuara. Masa e përfitimit të aftësisë së kufizuar, të përcaktuar në pikën 8, të VKM-së nr. 618, datë 7.9.2006, bëhet 10.540 (dhjetë mijë e pesëqind e dyzet) lekë në muaj për personat e përcaktuar në pikën 2, të vendimit dhe 11.070 (njëmbëdhjetë mijë e shtatëdhjetë) lekë në muaj për kujdestarin", - theksohet në vendimin e Këshillit të Ministrave. Ndërkohë masa e përfitimit për shkak të verbërisë, do të bëhet 11.965 lekë në muaj, e po të njëjten masë do të përfitojë edhe kujdestari i të verbrit, nga 11.500 lekë që ishte më parë. Efektet financiare, për zbatimin e këtij udhëzimi, fillojnë nga 1 shtatori i vitit 2018 dhe përballohen me fondet akorduara për vitin 2018, për Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

### KRITERET E PËRFITIMIT

Të gjithë ata persona që bëhen të paaftë për çdo veprimtari ekonomike dhe kanë dëmtime fizike apo gjytime të forta, duke përfshirë verbimin, iu lind e drejta për pension invaliditeti. Sipas ligjit nr. 7703, "Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar; invaliditeti klasifikohet në tri grupe. Invaliditeti i pjesshëm, është grupimi i parë, ku bëjnë pjesë të gjithë ata persona të siguruar që humbin aftësinë për punë në profesion, por janë ende në gjendje të kryejnë punë të tjera sipas përcaktimit të vendimit të KMCAP-it. Më tej grupi i dytë klasifikohet si invaliditet i reduktuar në rastet kur

Tabela me masën e shtuar/ Këshilli i Ministrave: Hyn në fuqi nga 1 shtatori i këtij viti.

# Vendimi, rritje pensionesh për invalidët e të verbrit

## Sa do të marrin kategoritë përkatëse dhe kujdestarët



Faksimile e vendimit të Këshillit të Ministrave

### RRITJA SIPAS KATEGORIVE

- ◆ Masa e përfitimit për invalidët paraplegjikë dhe tetraplegjikë, do të bëhet 10.540 lekë në muaj, nga 10.330 lekë që ishte deri në gusht.
- ◆ Kujdestari i këtyre personave do të marrë një pension prej 11.070 lekësh në muaj, nga 11.500 lekë që ishte më parë.
- ◆ Masa e përfitimit të aftësisë së kufizuar, të përcaktuar në pikën 8, të VKM-së nr. 618, datë 7.9.2006, bëhet 10.540 (dhjetë mijë e pesëqind e dyzet) lekë në muaj për personat e përcaktuar në pikën 1 të vendimit.
- ◆ Të njëjten masë përfiton edhe kujdestari i personit me aftësi të kufizuara.
- ◆ Masa e përfitimit të aftësisë së kufizuar, të përcaktuar në pikën 8, të VKM-së nr. 618, datë 7.9.2006, bëhet 10.540 (dhjetë mijë e pesëqind e dyzet) lekë në muaj për personat e përcaktuar në pikën 2, të vendimit dhe 11.070 (njëmbëdhjetë mijë e shtatëdhjetë) lekë në muaj për kujdestarin
- ◆ Masa e përfitimit për shkak të verbërisë, do të bëhet 11.965 lekë në muaj, e po të njëjten masë do të përfitojë edhe kujdestari i të verbrit, nga 11.500 lekë që ishte më parë.
- ◆ Efektet financiare, për zbatimin e këtij udhëzimi, fillojnë nga 1 shtatori i vitit 2018 dhe përballohen me fondet akorduara për vitin 2018, për Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

personi i siguruar bëhet i paaftë për çdo punë, ndërsa invaliditeti i plotë është

grupimi i fundit i kësaj kategorie pensionesh nga i cili mund të përfitojnë të gjithë

ata individë që ndodhen në kushtet e nevojës për kujdestari. Pension invaliditeti të plotë përfitojnë të gjithë ata persona që kanë plotësuar periudhën minimale të sigurimit, e cila është sa 3/4 e diferencës së moshës së personit të siguruar në kohën që bëhet i paaftë dhe moshës 20 vjeç. Gjithashtu, duhet që individit në 5 vitet e fundit para lindjes së të drejtës të ketë së paku 12 muaj sigurim shoqëror si dhe të ketë humbur plotësisht aftësinë për punë, jo për shkak të aksidentit në punë apo sëmundjes profesionale. E drejta për të përfitur këtë lloj pensioni fillon pas mbarimit të periudhës 6-mujore të trajtimit me raport mjekësor për paaftësi të përkohshme në punë. Ndërkohë në manualin e ISSH-së bëhet me dije se masa mujore e pensionit të plotë të invaliditetit përbehet nga pensioni bazë dhe nga një shtesë pensioni që llogaritet si pensioni i pleqërisë. "Shuma bazë e pensionit iu jepet gjithë personave të siguruar. Ndërsa shtesa që iu jepet personave të punësuar, është 1 % për vit sigurimi shumëzuar me bazën mesatare të vlerësueshme neto, që i siguruari ka arritur nëpërmjet kontributeve gjatë gjithë historisë së tij kontributive",

# 1

### SHTATOR HYRJA NE FUQI

Prejt datës 1 shtator të këtij viti, do të zbatohet rritja e pensioneve për të gjithë invalidët paraplegjikë, tetraplegjikë si dhe të verbrit.

# 75%

### SHUMA E PENSIONIT

ISSH bën me dije se shuma e përgjithshme e pensionit nuk mund të jetë më e vogël se 75 për qind e pagës minimale neto në shkallë vendi.

thekson ISSH. Gjithashtu, ISSH bën me dije se shuma e përgjithshme e pensionit nuk mund të jetë më e vogël se 75 për qind e pagës minimale neto në shkallë vendi. Sipas ligjit "Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë", në rastet kur përfituesi i një pensioni të plotë të invaliditetit bëhet i paaftë dhe ka nevojë për një kujdes të vazhdueshme nga një person tjetër, atij i jepet një pagesë shtesë prej 15 % të bazës së vlerësueshme neto. Ndërsa, një person që merr pension invaliditeti të plotë e ka fëmijë në ngarkim deri në moshën 18 vjeç, ose deri në moshën 25 vjeç kur vazhdon studimet e larta me shkëputje nga puna, do të marrë një të ardhur shtesë familjare për çdo fëmijë në masën 5 % të pensionit bazë, por jo më shumë se 30 % e tij.

### PENSIONI I REDUKTUAR I INVALIDITETIT

Individët, të cilët kanë humbur plotësisht aftësinë për të punuar, e që nuk kanë plotësuar periudhën minimale të sigurimit mund të përfitojnë pension të reduktuar invaliditeti. E drejta për të përfitur pension të reduktuar invaliditeti fillon pas mbarimit të periudhës 6-mujore të trajtimit me raport mjekësor për paaftësi të përkohshme në punë. Vlerësimi nga KMCAP duhet të bëhet në muajin e pestë ose të gjashtë, para përfundimit të kësaj periudhe. ISSH thekson se masa mu-

jore e pensionit të reduktuar të invaliditetit është e barabartë me masën e pensionit të reduktuar të invaliditetit të llogaritur sipas masës së pensionit të plotë të invaliditetit, shumëzuar me raportin e viteve të periudhës të sigurimit, që janë periudhat e sigurimit që i duhen për pension të reduktuar të invaliditetit. Gjithashtu, në rastet që ka nevojë për kujdestari si dhe në rastet kur ka fëmijë në ngarkim, pagesat llogariten po në njësoj si në pensionin e plotë të invaliditetit, me kushtet specifike përkatëse.

### PENSIONI I PJESSHËM I INVALIDITETIT

Ashtu si në rastet e sipërpërmendura, personat që bëhen të paaftë për të punuar përfitojnë në bazë të ligjit, pension të pjesshëm invaliditeti. Kushtet për ta përfitur këtë pension janë po njësoj me kriteret e renditura për 2 pensionet e tjera të invaliditetit. Ndërkohë masa mujore e pensionit të pjesshëm të invaliditetit përbehet nga pensioni bazë dhe nga një shtesë pensioni që llogaritet si pensioni i pleqërisë. Në manualin e Institutit të Sigurimeve Shoqërore theksohet se Pensioni i invaliditetit të pjesshëm është sa 50 për qind e pensionit të plotë të invaliditetit e llogaritet në të njëjten mënyrë si pensioni i plotë i invaliditetit.

Reagon motra në "News 24": Vëllai gënjen, kërkon të na zhvatë paratë

TIRANË

Xhevdet Lecini, baba i dy fëmijëve me disa marta të dështuara ka rrëfyer dje në emisionin "Me zemër të hapur" ngjarjen më të rëndë të jetës së tij, pasojat e së cilës vazhdon t'i vuajë akoma dhe sot.

Burri i motrës ka abuzuar seksualisht me gruan e tij teksa kishin shkuar për vizitë 15 vite më parë. "Kunati - tha 60-vjeçari - shfrytëzoi momentin kur ishte vetëm me të". E shoqja i ka rrëfyer gjithçka dhe ka kërkuar me insistim hakmarrje ndaj tij. Pasi e ka shqyrtuar këtë çështje me pjesëtarë të familjes së bashkëshorten, Lecini ka vendosur t'i vërë një gjobë prej 2 milionë lekësh të vjetra autoritetit të kësaj veprë të ulët dhe ky ishte kushti për të mos bërë denoncim ndaj tij në polici. Kunati nuk u ndëshkua dhe kjo ishte arsyeja që gruaja e Xhevdetit e braktisi atë dhe dy fëmijët e vegjël. Nderi i saj nuk u vu në vend. Djemtë u rritën pa nënë u shpreh ai, por edhe pse kanë kaluar kaç shumë vite, situata vazhdon po njësoj. Xhevdet Lecini kërkon të marrë lekët e gjobës, por kur e ka kërkuar këtë, motra e ka dhunuar duke e gjuajtur me gurë. Kjo ishte martesë e tretë e marrë fund për të. Ai e akuzon kunatin se nuk është hera e parë që e ka kryer të njëjtin veprim dhe kërkon lekët për të vënë në vend dinjitetin e humbur.

**DËSHMIA E 60-VJEÇARIT**  
"Unë jam martuar dy herë. Jam dënuar në kohën e komunistit me 4 vite burg për shkak të plagosjes që bëra, pasi më erdhën për të grabitur në shtëpi. Unë e bëra në shtëpinë time për mbrojtje. Kur rashë në burg, bashkëshortja që kisha u lidh me një tjetër. Kur dola nga burgju, u ndamë paqesisht. Pastaj u martova me gruan tjetër, me të cilën kam dy fëmijë", tregoi Xhevdeti. Ai tha se një ditë bashkë me nënën dhe gruan e tij kishin shkuar për vizitë tek motra ku kishte ndodhur edhe ngjarja e rëndë. "Nuk e dija që do ndodhte ajo që ndodhi. Kur shkuam atje, burri i motrës abuzoi me gruan time. Gruaja doli e na e tha të gjithëve, ishim 8 vetë. Pasi e diskutuam, motra tha se do paguaj gjobë, vetëm ta mbyllim këtu. Ramë dakord që të mos denoncoja, por motra nuk e pagoi gjobën", pohoi më tej babai i dy fëmijëve. Ndërkaq, 60-vjeçari sqaroi se kërkon gjobën prej 2 milionë lekësh, pasi ka frikë se fëmijët që janë në dijeni të situatës mund të hakmerren ndaj burrit të motrës së tij për nënën e tyre. "Fëmijët dinë gjithçka. Atëherë kanë qenë të vegjël, por e kanë marrë vesh dhe kam frikë se do kërkojnë të marrin hak. Gruaja ndaj më la, se nuk u vu dinjiteti në

# "Kunati më përdhunoi ish-bashkëshorten, kam frikë se fëmijët do të hakmerren"

## 60-vjeçari: Të paguajë gjobën 2 milionë lekë që të vë në vend dinjitetin e humbur

**HAKMARRJA**

"Fëmijët dinë gjithçka. Atëherë kanë qenë të vegjël, por e kanë marrë vesh dhe kam frikë se do kërkojnë të marrin hak. Gruaja ndaj më la se nuk u vu dinjiteti në vend. Ajo më thoshte vrite atëherë", deklaroi Xhevdet Lecini, ndërsa shtoi se për sa i përket marrëdhënies së motrës së tij me burrin, ka qenë e mirë. "Motra me sa di unë, me atë bashkëshort ndihet mirë. Ajo e di sjelljen e tij", tha Xhevdeti.



60-vjeçari Xhevdet Lecini, dje në "News 24"

**ABUZIMI**

Xhevdet Lecini tha dje se një ditë bashkë me nënën dhe gruan e tij kishin shkuar për vizitë tek motra ku kishte ndodhur edhe ngjarja e rëndë. "Nuk e dija që do ndodhte ajo që ndodhi. Kur shkuam atje, burri i motrës abuzoi me gruan time. Gruaja doli e na e tha të gjithëve, ishim 8 veta. Pasi e diskutuam, motra tha se do paguaj gjobë vetëm ta mbyllim këtu. Ramë dakord që të mos denoncoja, por motra nuk e pagoi gjobën", pohoi më tej babai i dy fëmijëve.

vend. Gruaja më thoshte vrite atëherë", deklaroi Xhevdet Lecini duke shtuar se për sa i përket marrëdhënies së motrës së tij me burrin ka qenë e mirë. "Motra me sa di unë, me atë bashkëshort ndi-

het mirë. Ajo e di sjelljen e tij", tha Xhevdeti.  
**REAGIMI I MOTRËS**  
Nga ana tjetër, motra e tij ka ndërhyrë me anë të një telefonate në studio, duke mohuar kategorikisht

akuzën e vëllait të saj. Ajo tha se nëse burri i saj do kishte përdhunuar nusen e vëllait, nuk do ta kishte mbajtur as një orë. Motra tregoi se Xhevdeti ka qenë disa herë i martuar dhe i ka torturuar

gratë dhe fëmijët. Sipas saj, ai kërkon para si gjithmonë. "Vëllai im është martuar 6-7 herë. Ai i rreh dhe i torturon gratë dhe fëmijët. Njëherë vjen tek unë, njëherë tek tjetra dhe do lekë. Nuk është asnjë llaf i vërtetë. Një herë në 4-5 ditë i sjell fëmijët këtu e kërkon lekë. Unë s'kam mundësi, jam e martuar, kam fëmijë. E kam ndihmuar", u shpreh motra. Por, edhe pas kësaj telefonate, Xhevdeti deklaroi se fshihen poshtërsi dhe këmbënguli për pagesën e gjobës.

**Vëllai në burg për vrasje, PD: Shkarkoni motrën e tij nga detyra**

**SARANDË** - Vrasja pak ditë më e 43-vjeçarit Alket Muho në fshatin Rabie në Memaliaj ka krijuar përplasje edhe në Sarandë, pasi motra e një autorëve është kryetare e Njësisë Administrative Ksamil. Nisur nga ky fakt, Partia Demokratike në Sarandë ka kërkuar që Valbona Oruçi, motra e 59-vjeçarit Hetem Muho të shkarkohet nga detyra. Sipas PD-së, ky vendim të jetë në fuqi deri sa të zbardhet ngjarja. Alket Muho u gjet i vrarë me plumba pas koke më 6 shtator në Rabie të Memaliajt, ndërsa për krimin në fjalë janë arrestuar Hetem e Dino Muho (babë e bir). Shkak i krimit dyshohet se është një konflikt i vjetër pronësie. Gjatë seancës për vendosjen e masës së sigurisë, dy të arrestuarit deklaruan se nuk kanë gisht në ngjarje.

**Kompania: Policia të zbardhë ngjarjen e të kapë autorët**

## Grabitja me armë nga maskat, koncesionari turk pezullon punën në minierës e Munellës

**PUKË** - Një ditë pas grabitjes me armë nga persona të maskuar është pezulluar puna në minierën e Munellës në punë. Koncesionari turk i nxjerrjes dhe pasurimit të bakrit në zonën e Pukës, dje nuk ka hapur dyert për fillimin si zakonisht të punës. Kompania ka njoftuar minatorët dhe punonjësit e tjerë se deri në një vendim të dytë, aktiviteti i saj në minierën e Munellës dhe fabrikën e pasurimit të bakrit në Fushë-Arëz do të pezullohet. Administratorët e koncesionarit, të kontaktuar nga "News 24", pohuan se është marrë vendimi që puna mos të nisë deri në zbardhjen e ngjarjes dhe zbulimin e autorëve. Dyshimet për një vjedhje të brendshme, nëse vërtetohen, do të shoqërohen me masa ekstreme deri në riorganizimin e një stafi të ri bërë të ditur kompania. Një



Miniera e Munellës

ditë më parë, njëri nga sektorët e minierës së Munellës ra preh e vjedhjes. Pasi keqberësit i bënë presion policit privat duke e mbyllur në vendroje, qetësisht kanë këputur kabllo të energjisë elektrike, duke shkaktuar sipas kompanisë një dëm që arrin në miliona lekë. Pezullimi i aktivitetit nga kompania ka lënë pa punë 100 punonjësit, të cilët nuk dinë

se kur do të rifillojë puna, teksa punëdhënësi duket se është i vendosur që mos të rinisë punën, derisa policia të zbardhë ngjarjen dhe arrestojë autorët. Policia, e cila ka shoqëruar disa persona në cilësimin e të dyshuarve, mësohet se deri tani ka ekzekutuar urdhër arrestet për dy policët privatë nën akuzën e shpërdorimit të detyrës.



Viktima Valton Loka

## Masakroi me thikë shqiptarin, burg përjetë 27-vjeçares greke

**GREQI** - Gjykata greke ka dënuar dje me burgim të përjetshëm një 27-vjeçare të droguar, e cila masakroi me thikë shqiptarin Valton Loka. Ngjarje kjo e ndodhur në nëntor të vitit të kaluar në ishullin e Kretës. Në seancën gjyqësore ishte edhe bashkëshortja e viktimës, e cila fajësoi autoritetet e vendit fqinj se askush nuk i ka ardhur në ndihmë asaj dhe dy fëmijëve. Gruaja shqiptare tronditi me dëshminë e saj, duke përshkruar se humbi bashkëshortin, shtyllën e familjes së saj. Ai u vra pa shkak dhe gruaja mbeti e vetme me dy fëmijët e saj të mitur, më i madhi 7 vjeç. Ajo tashmë është larguar nga Kreta dhe jeton në Gjermani. Ndërkaq, autorja e krimit deklaroi në sallën e gjyqit: "Nuk mund ta shikoj në sy gruan të cilës i mora jetën e burrit". Ajo shtoi gjithashtu se me viktimitë kishte marrëdhënie të mira, i cili shpesh e ndihmonte duke njoftuar ambulancën sa herë që ajo ndihej keq për shkak të drogës. Ndërsa prokurori i çështjes tha se autorja kishte vepruar me urrejtje ndaj viktimës dhe nuk ishte penduar për krimin. Ai kërkoi kështu dënim maksimal për 27-vjeçaren. Deklarata e tij nxiti reagimin e ashpër të së pandehurës. Gjykata e dënoi atë me burgim të përjetshëm dhe 2 mijë euro gjobë.



AKSIDENT MES TIRANËS? REAGON PËR HERË TË PARË ENCA

# SUMMER

pages

SUPLEMENT I GAZETË SHTIPTARË

E mërkurë 12 Shtator 2018



**Xhensila kthehet në formë, shfaqet si princeshë e veshur në lejla**



**Adelina Tahiri, me linja perfekte pas lindjes së djalit**

**BULEVARDI POLITIK**



- Manja i uron ditëlindjen, deputeti i PD-së Alibeaj mungon në komision
- 'Dita e parë e kopshtit', Elisa Spiropali publikon foton me vajzën dhe bashkëshortin
- Deputeti socialist me tri mandate djeg shaminë e beqarit, kolegët dalin në valle
- Deputeti i PS u përjashtua dje zyrtarisht, reagon gruaja e Gjetan Gjetanit



**Ja metodat motivuese që kthejnë vetëbesimin tek vajzat e kolme**

## ELDA KOCIA:

# Luftoj me shoqërinë që të heqë dorë nga paragjykimet

*"Perfeksioni është një standard i paarrtshëm"*

Ja metodat motivuese që kthejnë vetëbesimin tek vajzat e kolme

# Elda Kocia:

## Luftoj me shoqërinë që të heqë dorë nga paragjykimet

*"Perfeksioni është një standard i paarritshëm"*

Egla Xhemali

**B**ukuria e shpirtit është më e rëndësishme se gjithçka tjetër. Këtë na e pohon Elda Kocia, që ndan me ne të fshehtat e vajzave të kolme, mbështetjen që u jep atyre si dhe synimet që ka për të ardhmen. Ndryshe nga vajzat që kanë komplekse të pranojnë faktin se janë disa kile më tepër, ajo e qeshur na thotë se ndihet e lumtur dhe se mund të qëndrojë me orë të tëra para pasqyrës duke admiruar veten. Për "Summer Pages", Kocia rrëfen se si u vjen në ndihmë vajzave të kolme që u ka humbur besimi. Ajo nuk e privon veten nga asnjë ushqim. Sipas saj, është organizmi ai që jep sinjal se nuk duhet të hash më. Familja dhe bashkëshorti janë mbështetës të mëdhenj në çdo hap që ndërmerret. Rrjetet sociale janë një mundësi mjaft e mirë për t'u kujdesur për vajzat që janë demoralizuar dhe paragjykohen nga shoqëria. Elda pikërisht për këtë po lufton fort e deri më tani ia ka dalë. Synimet e saj për të ardhmen janë disa. Në të dominon dëshira për t'i ardhur në ndihmë kujtoda që ka rënë në dëshpërim të thellë dhe hapja e një vendi qetësues për mendjen dhe shpirtin. Në i ruojmë suksese dhe realizim të sa më shumë veprave të mira!

**Sa rëndësi ka pesha sot?**

Rëndësi sot ka që të kemi një shëndet të mirë, të ushqehemi mirë dhe të kemi aktivitet fizik. Këto mund t'i bësh në çfarëdolloj peshe. Është e kotë të fiksohesh me numrat e peshores, ku trupi i njeriut është me i komplikuar se thjesht një numër në peshore.

**Vajzat kanë synimin të kenë gjithmonë linja perfekte. Ka edhe nga ato që bëjnë zgjedhje të veshjeve të gjera, pasi janë të kolme. Cila është këshilla juaj për to?**

Perfeksioni është një standard i paarritshëm, që shoqëria jonë ka vendosur. Shoqëria e ka kthyer trupin e njeriut në modë, siç ka kthyer çdo gjë tjetër. Por, jo të gjithë e kanë këtë strukturë dhe metabolizëm për të përmbushur këtë modën e perfeksionit. Prandaj influ-




encier nga e gjithë bota, që bëjnë pjesë tek komuniteti i "Body Positive" po luftojnë për të ndryshuar këto standarde, ku çdo trup është i bukur si kolmë, si i dobët, si me forma, si pa forma. Sa u përket veshjeve, është po prapë standard ku tregojnë "femrat e kolme duhet ta fshehin trupin e tyre dhe nuk kanë të drejtë të ndjehen sexy me veshje të ngushta pas trupi".

**Ë keni vuajtur ndonjëherë paragjykimet?**

Sigurisht i kam vuajtur edhe unë paragjykimet, por gjithmonë kam qenë një tip shumë pozitiv dhe moskëqarës dhe kam ditur t'i kthej përgjigjen e duhur çdokujt, që i ka

futur hundët apo i ka prishur ndonjë punë shëndeti im. (qesh)  
Kaloni shumë kohë para pasqyrës? Duke e admiruar dhe duke e dashuruar veten çdo ditë. Shumë herë vajzat e fillojnë paragjykimin vetë, duke e parë veten në pasqyrë dhe duke e kritikuar për çdo gjë, madje duke e sharë veten pse duken në atë mënyrë, pse nuk duken si dikush tjetër. Krahasimi i vetes me dikë tjetër është një gabim i madh që mund të bëjmë. Ne të gjithë jemi të veçantë në llojin tonë. Në psikologji ky është një lloj ushtrimi për të rritur vetëbesimin. Ku ti i flet vetes me dashuri dhe adhurim, e inkurajon veten që ti mund t'ia dalësh, ti je e



bukur: nuk ka asgjë që s'shkon me trupin tënd. Kjo nuk është aspak mendjemadhësi, është një ndihmë për të fituar vetëvlerësimin dhe vetëbesimin, ku këto të dyja të çojnë shumë larg dhe të bëjnë shumë të suksesshëm.

**A e privoni veten nga ushqimet?**

Po, e privoj veten nga ushqimet, sepse më pëlqen të ushqehem pastër si mund ta themi... Unë kam një moto në jetë dhe kjo është të eci bashkë me intuitën time. Këtë e praktikoj edhe tek ushqimi. Quhet "Dieta intuitive" dhe është një mënyrë e të ushqyerit duke dëgjuar organizmin tënd se çfarë të habet dhe sa të habet. Në momentin që ti je e ngopur, organizmi të jep sinjal,

që mjaft hëngre se jam i ngopur, po ashtu funksionon me dëshirën për të ngrënë ushqime që kanë vlera ushqyese që të ndihmojnë të jesh energjike. Pastaj janë edhe ushqimet që janë për kënaqësinë e shpirtit si çokollatat dhe akulloret etj. Edhe ato lejohen një herë në javë, sepse nuk mund t'ia bësh shpirtit me hile.(qesh)  
Kujdesesh për trupin dhe për shpirtin kur ushqehesh.

**Ka pasur ndonjë moment që do e konsideronit të sikletshëm?**


Vetëbesimi im nuk më lejon të kem momente të sikletshme, pasi kam shumë kujdes për veten dhe për trupin tim. Eci gjithmonë me kokën lart dhe me siguri për gjërat që unë dua të bëj.





## Xhensila kthehet në formë, shfaqet si princeshë e veshur në lejla

Vetëm pak kohë më parë këngëtarja Xhensila Myrtezaj është bërë nënë për herë të parë. Duket se dalëngadalë ajo po rikthen format e saj trupore. Këtë herë e shohim më të ëmbël se kurrë, të veshur me një fustan lejla. Xhensila duket mjaft në formë, ndërkohë që ka publikuar disa foto me këtë veshje. Bukuroshja e hitit "Çika çika" ka qenë mjaft aktive në rrjetet sociale këto kohë, ku nuk kanë munguar imazhet nga ditët e relaksit dhe përditshmëria e saj.



## Aksident mes Tiranës? Reagon për herë të parë Enca

Ditën e djeshme qarkulloi me shpejtësi një lajm, sipas të cilit Enca ka bërë aksident me makinën e saj pak metra larg qendrës në Tiranë. Qarkulloi lajmi se Enca ishte përplasur në orët e para të mëngjesit me mjetin tip "Scoda" dhe ka goditur një "Range Rover". Por, si duket vajza në video nuk është Enca. Kjo, pasi ka qenë vetë këngëtarja, e cila e ka mohuar aksidentin. Enca është shprehur se vajza në video nuk është ajo dhe se ndjekësit e të afërmit duhet të qetësohen. Enca është mirë me shëndet dhe për më shumë, këngëtarja nuk ka një "Scoda", por "Benz".



**Jeni mjaft e ndjekur në rrjetet sociale. Çfarë ju bën të veçantë?** Besoj se më bën të veçantë fakti që "Instagram"-i im është edukativ, shumë pozitiv, ku çdokush ndihet mirë kur hyn te profili im. Unë kam mbaruar shkollën për Punë Sociale dhe do vazhdoj masterin për Këshillim Psikologjik. Unë në "Instagram"-in tim ndihmoj vajzat që të fitojnë vetëbesimin, të ndihen rehat me trupin e tyre dhe sigurisht, të kujdesen për veten dhe të kenë një shëndet sa më të mirë. Pothuajse në çdo foto timen ndodhet një shkrim, ku mund të jenë tema sociale, që u vjen në ndihmë shumë personave. Plus bëj edhe terapi 'online' ku çdokush që ka nevojë për një psikolog falas, kërkon ndihmë për të zgjidhur një problem, unë këshilloj dhe jap ndihmën time.

**Keni pasione të fshehta?** Pasionet e mia nuk janë më të fshehta. Më pëlqen që të jem një ndihmë për shumë njerëz në shumë fusha. Më pëlqen të shkruaj dhe jam në përfundim të librit tim të parë "Dashuro Vetën". Më pëlqen të stilloj, prandaj jam duke hapur biznesin tim me veshjet në të gjitha masat, ku të gjitha vajzat mund të ndihen të bukura me veshje që shfaqin vetëbesim. Më pëlqen të kërcej dhe të bëj Yoga dhe të qesh (qesh). Si nis një ditë e zakonshme për ju? Dita ime nis herët, në orën gjashtë, ku shëtis qenushen time. Më pas bëhem gati për në punë. Jam përgjegjëse e "Spa" në një hotel të njohur, ku kaloj tetë orë të ditës sime. Më pas kam dhe biznesin tim të trajtimeve të fytyrës, që punoj pasdite. Më pas pjesa tjetër e kalon me bashkëshortin dhe me familjen time. Është një ditë që kalohet me punë. Mendoj se njëri duhet të luftojë në vitet e rin-

isë për të ardhmen që dëshiron të ketë.

**Ju po bëni një "luftë" të vazhdueshme që t'i ndihmoni vajzat e kolme. Sa ju ka mbështetur familja në këtë nisim?** Kam pasur mbështetje shumë të madhe nga familja dhe nga bashkëshorti im. Sepse përveçse bëj një luftë për vajzat e "kolme", unë bëj një luftë për të gjithë shoqërinë që të heqin dorë nga paragjykimet, bulizmi, që në i bëjmë njëri-tjetrit, luftoj për një shëndet të mirë mendor. Para se të isha në ndihmë për të gjithë ato vajza që unë bëj terapi, kam qenë një ndihmë e të gjithave atyre që janë afër meje. E ku ka më mirë se sa të kesh një psikolog në shtëpi, që t'i bën gjërat të kalojnë me lehtë.

**Jeni e martuar, por nuk keni bërë ceremoni. Pse kjo zgjedhje?** Mendoj se të martuar nuk të bëjnë letrat. Të martuar të bën dashuria pa kushte, respekti për njëri-tjetrit, bashkëpunimi në të gjitha fushat e jetës. Prandaj jam martuar me Serxho Muzhaqi, sepse ka qenë mbështetja ime më e madhe dhe shoku im i jetës.

**Cilat janë synimet tuaja për të ardhmen?** Synimi im i parë është të krijoj familje. Dua të jem në institucionet shtetërore, sepse mendoj se kam shumë njohuri për t'u dhuruar fëmijëve dhe adoleshentëve sesi t'i kalojnë këto vite të bukura të jetës, jo në depresion dhe jo në ankth, jo duke sharë njëri-tjetrit. (Me organizatën "Pink Movement" kemi bërë disa seminare nëpër gjimnaze dhe shumica e këtyre vajzave vuanin nga ankthi. Vajzat e organizatës u munduan t'i ndihmonim sadopak ato). Synimi tjetër kam edhe hapjen e një vendi mikpritës, qetësues, kurues, ku do ketë si bazë shëndetin mendor dhe atë fizik.

## Adelina Tahiri, me linja perfekte pas lindjes së djalit

Vetëm pak javë më parë ajo solli në jetë djalin e quajtur Jon.

Këngëtarja Adelina Tahiri në mënyrë të vazhdueshme ka ndarë me ndjekësit e saj momente të shtatzënisë, duke preferuar që këtë pjesë të mos e mbajë hermetike. Këto javë të para normalisht që kanë qenë të dedikuara plotësisht për djalin. E kjo mbase ka bërë që Adelina të humbasë peshë, pa u përpjekur fort. Këngëtarja ka lënë pa fjalë ndjekësit në rrjetet sociale me fotografinë e postuar, ku shfaqet në top formë.



## Manja i uron ditëlindjen, deputeti i PD-së Alibeaj mungon në komision

Edhe në mbledhjen e djeshme të Komisionit të Ligjeve, opozita ka zgjedhur të mos jetë e pranishme. Por edhe pse jo aty, në fillim të mbledhjes, kreu i Komisionit të Ligjeve, Ulsi Manja nuk harroi të uronte kolegun demokrat Enkelejd Alibeaj për festën e ditëlindjes.

"Përpara se të nis mbledhjen me rendin e ditës, pavarësisht mungesës së kolegeve të opozitës dua t'i uroj kolegut Alibeaj 45-vjetorin e lindjes. Urimet më të mira",-i tha Manja kolegut në mungesë.



## 'Dita e parë e kopshtit', Elisa Spiropali publikon foton me vajzën dhe bashkëshortin

Deputetja e PS Elisa Spiropali ka ndarë me ndjekësit e saj në rrjetet sociale një foto të familjes. Sot ka qenë një ditë e veçantë për vajzën e saj Nalta, e cila ka nisur kopshtin. Deputetja shfaqet me vajzën dhe bashkëshortin, teksa duken mjaft të qeshur në ambientet e kopshtit. Fotoja e publikuar sigurisht që ka marrë vëmendjen e ndjekësve, të cilët nuk kanë hezituar të lënë komentet e tyre.



# BULEVARDI POLITIK

*Në merrni seriozisht!* 😊

## Deputeti socialist me tri mandate djeg shaminë e beqarit, kolegët dalin në valle

Deputeti socialist Anduel Xhindi i ka dhënë fund beqarisë duke u martuar. Ceremonia e martesës është kryer në një nga lokalet e kryeqytetit, ku të pranishëm kanë qenë jo vetëm miq dhe familjarë të tij, por edhe kolegë deputetë. I pranishëm ka qenë edhe Kryetari i Kuvendit Gramoz Ruçi, së bashku me kryetarin e Grupit Parlamentar Taulant Balla, por nuk ka munguar as ministri i Brendshëm Fatmir Xhafaj. Ajo që spikat është rikthimi i buzëqeshjes tek Ruçi teksa troket gotën me verë.



## Deputeti i PS u përjashtua dje zyrtarisht, reagon gruaja e Gjetan Gjetanit

Grupi Parlamentar i Partisë Socialiste zyrtarizoi përjashtimin e deputetit të Kurbinit Gjetan Gjetani pasi më herët, direkt nga Asambleja, kryeministri Edi Rama kërkoi largimin e menjëhershëm të tij. Gjetani u përjashtua nga grupi i PS pasi akuzoi ashpër Policinë e Shtetit për dy vrasjet në Mamurras. Ndërkaq, ka reaguar bashkëshortja e tij, Albana Gjetani përmes një komenti lënë në profilin e fotografit Agim Rama. "PADREJTËSI". Kështu e cilëson Albana Gjetani përjashtimin e të shoqit nga PS. Vetë Gjetani tha në reagimin e tij se nuk është Rama ai i cili e bëri socialist e për rrjedhojë nuk mund ta përjashtojë nga PS.





Marrëveshja me Maqedoninë, kryeministri grek: Ia dolëm pas 26 vitesh

# Tsipras në PE: Mbështesim dialogun e vazhdueshëm me Shqipërinë

"Ndryshuam kapitull pa dhunë, por me diplomaci"

Aleksis Tsipras, kryeministri i Greqisë, fjalën e tij në Parlamentin Europian e ka përqendruar te dialogu, integrimi evropian dhe zgjidhja e mosmarrëveshjeve në rajon. Ai tha se mbështet dialogun e vazhdueshëm me Shqipërinë ndërsa marrëveshjen pas 26 vitesh me Maqedoninë e konsideron model për vendet e tjera. "Duam të mbështesim integrimin evropian të fqinjëve tanë, me marrëveshjen e Prespës, dhe dialogun e vazhdueshëm me Shqipërinë". Sipas kreut të qeverisë greke marrëveshja e arritur për emrin e Maqedonisë është një model se si mund të zgjidhen mosmarrëveshjet në rajonin tonë. "Me këmbënguljen tonë arritëm marrëveshjen historike të Prespës si dhe kemi realizuar dialogun e vazhdueshëm me Shqipërinë. Pas 26 vitesh nacionalizëm destruktiv ia dolëm të flasim me Zaev dhe të kemi një marrëveshje me diplomaci dhe pa përdorimin e forcës. Kjo marrëveshje mund të jetë një model për vendet e tjera. Të ndryshojmë kapitull duke arritur në një marrëveshje me interes reciprok, pa ndërhyrjen dhe ushtrimin e fuqisë por bazuar në diplomaci dhe dialog". Pjesa e parë e fjalës së Tsipras u përqendrua tek përpjekjet e qeverisë dhe popullit grek për të kapërcyer krizën e borxheve. Kryeministri grek u shpreh optimist se vendi ia ka dalë që nga pjesë e problemit të BE-së të behet pjesë e zgjidhjes, megjithëse shumica ishin skeptikë për suksesin në fillim të mandatit qeverisës. Ndërkohë që marrëveshja me Maqedoninë për emrin është arritur në 12 qershor të këtij viti. Athina dhe Shkupi arrijnë më në fund paktin për emrin dhe bien dakord që zgjidhja të jetë: Republika e Maqedonisë së Veriut. Dy kryeministrit Aleksis Tsipras dhe Zoran Zaev i janë drejtuar kombit me nga një mesazh. "Arritëm një marrëveshje historike me Greqinë. Kjo është një ditë e mirë për Maqedoninë. Me këtë marrëveshje kemi identitetin, gjuhën dhe kulturën tonë", deklaroi kryeministri maqedonas, Zoran Zaev. Ndërsa kryeministri grek Alexis Tsipras në atë kohë tha: "Arritëm marrëveshjen me Zoran Zaev. Fqinjët tanë do të njihen nga 140 shtete si Republika e Maqedonisë së Veriut".



Kryeministri i Greqisë, Aleksis Tsipras

## ALEKSI TSIPRAS

"Duam të mbështesim integrimin evropian të fqinjëve tanë, me marrëveshjen e Prespës dhe dialogun e vazhdueshëm me Shqipërinë. Me këmbënguljen tonë arritëm marrëveshjen historike të Prespës, si dhe kemi realizuar dialogun e vazhdueshëm me Shqipërinë", - tha Tsipras.



Akuzohet se abuzoi me vajzën e mitur, reagon ish-deputeti i Kosovës

Numan Balić, ish-ministri dhe ish-deputeti i Kuvendit të Kosovës, është akuzuar se ka abuzuar seksualisht me një vajzë të mitur. Ndërkaq ish-deputeti nuk ka pritur të reagojë duke mohuar akuzat. "Janë shpifje e mediave", tha ai për "Express". Mediat në Kosovë raportuan se 60-vjeçari është kallëzuar nga e ëma e një vajze 17 vjeçe e komunitetit boshnjak, Selma M., duke thënë se politikanin ka abuzuar me të bijën. Pas marrjes së denoncimit, organet ligjzbatuese kanë marrë në pyetje ish-zv/ministrin Balić, i cili më pas është liruar. Lidhur me këtë çështje ka reaguar edhe Stacioni i Policisë së Kosovë në Pejë. Zëdhënësi për Informim në këtë rajon, Driton Rugova ka folur për "Indeksonline". "Po, është lajmëruar një rast për abuzim seksual me një të mitur. Personi është arrestuar, por është vetëdorëzuar në polici e më pas prokurori përkatës e ka liruar në procedurë të rregullt", ka deklaruar ai.



Deklaratat e Vuçiç për Milloshevićin, reagon presidentja kroatë

Pas disa ditësh, gjatë vizitës në Kosovë, presidenti i Serbisë, Aleksander Vuçiç, ka lartësuar figurën e kriminelit, kasapit të Ballkanit, Sllododan Milloshević. Ai ka vazhduar të përdorë retorikën nacionaliste duke thënë se, Serbia do t'i mbrojtë serbët në Kosovë, ndërsa shtoi se në këtë kaluarin serbët kanë vdekur për Kninin, për Sarajevën e për Prishtinën. E pas deklaratave skandaloze të Vuçiçit, ka reaguar presidentja e Kroacisë, Kolinda Grabar-Kitarović. "Flamuri kroat është valëvitur në Knin dhe para se të flasë Vuçiç, dhe flamuj blu do të jenë edhe në të ardhmen", deklaroi presidentja kroatë, Kolinda Grabar-Kitarović për "DNEVNIK.hr". Më tej, ajo ka thënë se nuk do ta lejojë Vuçiçin që të përzihet në çështje të tilla, apo të përcaktonte agjendën politike në Kroaci.

Ende qëndron pezull çështja lidhur me emrin e Maqedonisë, deri më 30 shtator kur dhe pritet të realizohet referendumi. Nga ana tjetër, pse të ndara për një sërë çështjesh, partitë politike në Maqedoni bashkohen në një pikë dhe ky është referendumi i 30 shtatorit. Ato njëzëri shprehin se mbështesin referendumin për zgjidhjen e çështjes së emrit me Greqinë, ndërsa bëjnë thirrje që qytetarët të dalin në votime. BDI-ja, Aleanca dhe Besa janë në një linjë në këtë drejtim, pasi sipas tyre, referendumi i hap rrugë vendit në anëtarësimin e strukturave euro-atlantike. Përfaqësues të këtyre partive kanë folur për mediat në Maqedoni, ku pikëpamjet e

## Referendumi në Maqedoni, shqiptarët i japin dritën "jeshile"

Deputeti i BDI: Pa ndërhyrjet e partisë sonë, s'do të ndodhnin ndryshimet pas 27 prillit



tyre janë në të njëjtën kornizë. "Këtu kemi njerëz, të cilët kanë qenë në qeverisjen e kaluar dhe cuditërisht iu bashkëngjitën kësaj shumice me po të njëjtën retorikë, po i bëjnë konfuz edhe njerëzit

zojnë apo t'i marrin meritat për vetë", deklaroi Arianit Hoxha nga Lëvizja BESA e Kasamit. "Një ndër shtyllat, nga tre shtyllat kryesore të BDI-së është integrimi i vendit në NATO dhe Bashkimin Evropian. Ne japim përgjegjësi për pjesën tonë të bashkëqeverisjes në të kaluarin. Por ne jemi dëshmitarë se pa Bashkimin Demokratik për Integrim nuk do të ndodhnin ndryshimet që u bënë pas 27 prillit", theksoi Rexhail Ismaili, deputet i BDI-së.

Pas takimit të Thaçit me përfaqësuesit e Luginës së Preshevës, një tjetër reagim ka ardhur nga kreu i qeverisë së Kosovës, Ramush Haradinaj, pas mbledhjes së qeverisë u pyet nga gazetarët nëse ai përkrah si kryeministër rezolutën e propozuar nga përfaqësuesit e Luginës së Preshevës, për bashkim të Luginës me Kosovën. Duke mos u përgjigjur direkt pyetjes, Haradinaj tha se si kryeministër, ai e ka për detyrë të respektojë Kushtetutën e vendit. "Ne do të mbajmë çdo herë vëmendjen dhe interesimin për Luginën e Preshevës.

## Ramush Haradinaj: Loja me kufij, eksperiment i rrezikshëm



Detyra ime është zbatimi i Kushtetutës së vendit dhe ajo na obligon edhe në territor edhe në kufij", tha Haradinaj, raporton "Zeri.info". Ai po ashtu shtoi se hapja e çështjes së kufijve është "Eksperiment i rrezikshëm dhe

jam kundër këtyre lëvizjeve, dhe i sugjeroj që të gjithë të kenë parasysh këtë". Ndërsa mes të tjerash Haradinaj u pyet nëse ka mundësi që të vizitojë Luginën e Preshevës në të ardhmen. "Si Ramush Haradinaj po, si kryemi-

nistër nuk e di", tha ai. Ndërkaq ditën e hënë, presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, pati një takim me përfaqësuesit e Luginës së Preshevës. Thaçi i ka dhënë edhe njëherë mbështetje vullnetit të shprehur të shqiptarëve të Luginës së Preshevës, Medvegjes dhe Bujanovcit për t'u bashkuar Kosovës. Ai ka mbështetur edhe përfshirjen e përfaqësuesve të këtyre komunave në delegacionin e Kosovës në kuadër të dialogut me Serbinë.

LIBRI

# Kur Simon Rrota ishte skenograf i dramave të Fishtës

Nga Tonin Çobani\*

Kujtimet e piktorit Simon Rrota janë shkruar me vëmendjen e një piktori që befasohet edhe vetë me nuancat kromatike që kishte jeta e një qyteti, si Shkodra, sado gri që të na duken sot historitë e tij për shkak të përpjekjeve për ta mënjeluar atë qytet nga historia kombëtare.

Dua ta veçoj që në krye një fakt historik, ku është i përfshirë edhe Gjergj Fishta, i cili dëshmohej në kujtimet e Simon Rrotës: Lufta me armë zjarri midis të ngjuarve të "Popullores" në prefekturën e Shkodrës dhe "Opozitës":

"Kështu në muezin qersher 1924, shkruan Rrota në kujtime e veta, - nji pjesë e zogistave, bashkë me to edhe Musa Juka, umbyllën për qindresë në Prefekturën e Shkodrës. Në këtë mënyrë, ndërmet dy partive, nisi nji luftë e rreptë nga ana e Opozitës që me pushkë e mitraloza qitshin kundër atyne që ishin të mbyllun mbrendë e qi u përgjegjshin po me pushkë, atyne të jashtëmve. Luftimi filloi me 29 qersher e mbaroi me 1 korrik. Partija "Popullore" tue pa se kurrnji dobi nuk i solli ajo qëndresë e tyne, kërkuan kondita me iu dorëzue "Opozitës". Mbas i mblodh komisioni, në të cilin bante pjesë edhe Pater Gjergj Fishta, i cili shtroi kondita me Musa Jukën e tjerë, qi me ilanë të lirë me dalë prej Shqypniet pa u dhanë pengesë. Kjo pikë u pranue e ata u larguen prej vendit tonë.

Fjala e fitores u hap nëpër qytet - vazhdon piktori Simon Rrota. - Ushtrija kishte marrë në dorë fuqinë, mori nën drejtimin e saj administratën, doganat, etj. Ndërkaq populli kishte dallë me pa nëpër qytet tue shtetit, efektet e luftës e dame qi ishin ba: xhama e dyer te thymë e njkohësisht panë edhe kapidan Feridin të xhandarmërisë, të cilin e vranë në dritare të Prefekturës njatëherë kur palët luftoshin."

E nisa me këtë episod, sepse historia e ideologjizuar e derisotme, jo vetëm që ka mënjeluar qytetin verior nga opozitarizimi përfaqëses i takon, por, duke mbajtur ende të mënjeluar edhe sot e kësaj dite figura të dala me pa nëpër qytet (dhe veprën e tij), vazhdon të mbetet një histori, e cila nuk mund të funksionojë më pa u rishikuar. Përveç Fishtës e sa e sa të tjerëve mua më duket i

mënjeluar edhe Luigj Gurakuqi për deri sa shtëpia e tij muze nuk është më as si objekt i vizitueshëm as në planet e Ministrisë së Kulturës për rikonstruksion. Nga ana tjetër, paragrafi i mësipërm na dëshmon sa aktiv ka qenë asokohe Fishta. Ai vetë, që na ka lënë një analizë të zgjeruar për "Trazirat e qershorit" (Hylli i Dritës), shkruan afërsisht për të njëjtin episod që dëshmon Simon Rrota:


"S'ngjati, edhe krisi pushka. Ushtria Kombëtare, ndihmë prej vullnetarëve të Gegënisë të Toskënisë, jo ma tepër se me dhjetë ditë kohë, shtypi rebelët e Shkodrës, ndrydhi kaçakët e Lezhës, dërmoi komitaxhitë e Beratit e në Kala të Dodës zdrypi (zbriti) për veshi bashibozukët e Matit e të Dibërës, edhe mësyni e mori Tiranën. Ahmet Zogolli, e me të ikën edhe ata, që ndërgegjen kombëtare e kishin pasë të përlumë. E kështu u vërtetue fjala e Mehdi Frashërit, i cili me 23 prill 1923 i pati gërrthit Ahmet Zogolli: "Me gjak e ke marrë; me gjak je tue e mbajtë, e pa gjak s'ke me e lëshue". (Hylli i Dritës, 1924/5-6).

Duke pasur të bëjmë me kujtimet e një piktori, është e prapshme që të informohemi me zhvillimin e pikurës në atë qytet, si dhe me piktorët dhe autorët e tjerë figurativë. Njëri prej tyre është Gjergj Fishta, i cili portretizohet prej Simon Rrotës si poet me autoritet në qytetin e Shkodrës për vargjet e tij patriotike:

"Ai (at Gjergj Fishta) me vjershat e tija patriotike, e veçanërisht me atë të famshmen "Lahuta e Malcis" i dha nji shkas të madh popullit tonë për me njoftë sejcili prej nesh se kush kjeme përpara e si jena sot." Ja si e përshkruan ai takimin e parë me Fishtën, më parë se të ftohet për të punuar disa skena të komedisë së Molierit, "Mjek përdhuni":

"Por me u paraqitë te Padër Gjergji më vinte turp mbasi qi ishte e para herë që do të flitshme me të... Rasa kje e mirë për mua me u takue së bashku, pse, njatë herë ai kishte ndejë në kopësht të Kuvendit, ku sot asht nji bli i madh, ndërsa po vërente punëtorët qi po ndërtojshin Kishën e Françeskanëve..." Dhe më tej, kur fillon punën si scenograf (duke punuar përkrah poetit), shprehet:

"Kjo do të ishte rasa ma e mirë për mue me pasë përpjekje ma të ngushta me poetin tonë"



Botohet libri me kujtime i piktorit: "Po shkruaj për vedi e Shkodër"

"Edhe ai vetë, mori pjesë me mue, në punimin e atyne skenave mbasi vizatimi i vinte shumë për dorësh, e kështu punojshim bashkë. Ndërsa unë, pa pushim me brushat e mija ngjyroshme në ata skena të bukura, poeti recitonte vjersha e lëshonte disa batuta satirike qi mue me bajshim me qesh aq shumë sa mu donte me lanë edhe punën, tue i thanë se nuk mujshe me vazhduë ma, pse dhimbje të mëdha me kishin kapë dejt e qafës prej të qeshurit të fortë. E kështu, tue e pa edhe ai vetë, menjherë u largue, por me nesre e shof se po vinte, e me vehte kishte pru do vjersha të pregadituna prej tij. Unë i mbylla deren e teatrit (Teatri i Françeskanëve, ndodhej djathas në oborrin e Shkollës "Vasil Shanto") e nuk e lashë me hy mbrendë, por mbas pak kohët qi ai qindroi jashtë deret, me premtosi se nuk do të me trazontë ma e, me këtë konditë, i cila derën. Por premtimet e tija kjenë të shkurtat e tue pa se skena po delte e bukur, ndërsa po pinte cigare e kafe së bashku me mue afër tangarit (mangallit), në njatë kohë ia mbërriti Mati Logoreci qi atëherë ishte mesues në Shkollën Françeskane. Prandaj rasa kje e mirë për poetin me na lexue vjershat e pregadituna aq bukur ku ndër të kishte përmende vedim edhe mue, si edhe disa tjerë qi vjishin aty me na pa. Por në këtë mënyrë, puna nuk ecte përpara, koha ishte e sh-

kurtë, skenat do t'u mbarojshin sa ma parë. Për këtë arsye, lidhem konditë me poetin qi mos me m' trazue ma me vjersha të tjera. E me të vërtetë e mbajti fjalën e kështu gjithshka kje plotësue mbrenda nji kohë të shkurtë."

3. Por aksioni më i rëndësishëm i Poetit tonë është futja e gjuhës shqipe si gjuhë mësimi në të gjitha shkollat françeskane (1902). Edhe si gjuhë në veprimtaritë edukative-argëtuese. Kam parasysh këtu teatrin fishjan, teatër i cili ka lidhur Simon Rrotën, si scenograf me Gjergj Fishtën si dramaturg e regjisor. Ne sot nuk e njohim mjaftueshëm punën e scenografit Simon Rrota, por kemi pohimin e tij se ishte scenograf i Kolegjit të Françeskanëve dhe i Kolegjit të Vajzave Stigmatine ("unë ishte scenografi i Teatrit Françeskan dhe i atij të Motrave Stigmatine").

Komedia e Molierit "Mjek përdhuni" është shfaqja e parë teatrore në Shkodër (por edhe në Shqipëri), sepse "më përpara nuk ishin shfaqur shfaqje në gjuhën shqipe", shkruan piktori Simon Rrota. Dhe "drama pati sukses të madh... - vazhdon ai në kujtimet e veta, veçanërisht pse ishte në gjuhën shqipe... prandaj bani një përshytyje të madhe në popull, (i cili) e priti me duartkrytë të vazhdueshme, në drejtim të poetit tonë"

4. Gjergj Fishta e trajtoi si

koleg piktorin e ardhshëm me gjithë diferencën në moshë (Fishta i kishte 16 vjet para Simonit). E ndihmon me materiale për vizatim, i siguron vend pune në bibliotekën e kuvendit, ku gjente qetësi dhe shfrytëzonte librat e artit që Fishta i blinte për të pasuruar bibliotekën kuvendit sa herë udhëtonte nëpër Europë: "Ngushllimi ma i madhi qi muejshe me pasë unë, ishte vetëm Kuvendi i Françeskanëve, shkruan Simon Rrota, - pse aty, në bibliotekën e tyne, gjeshe atë çka unë dishrojshe, tue pa prodhime veprash hartistike qi me inpsirojshin shumë e me nepshin zemër me punue e me harue njehierit edhe disprimin tem. Veçanërisht njatë herë kur Patër Gjergji ishte kthye prej Italisë e më fali do materiale për pikturë: bojna, penela etj. e më tregon te shumë vepra artistike qi kishte pa atje. Për mue kjenë momentet ma të gëzueshme..."

( Simon Rrota, krahas Patër Gjergj Fishtës rreshton edhe Patër Vincenc Prendushin e Patër Ambroz Marilaskajn, të cilët e kishin ndihmuar artistikisht ("për nevoja artistike"), për kompozicionin e veprave fetare që realizonte për kisha etj, duke e krahasuar veten, në një farë mënyre, me "Rafaelin (Rafaelo Sanzio), (i cili) kur donte me paraqitë vepra fetare klasike, shkonte gjithëherë te Kardinal Bibiena, për me marrë udhëzime të sigurta për figurat qi do të bante ndër veprat e veta".

5. Për të përfunduar do të

ndalem në dy korrigjime që na duhet të bëjmë tani që kemi në dorë kujtimet e piktorit Simon Rrota. Të dyja janë të lidhura me teatrin. Korrigjimi i parë ka të bëjë me shfaqjen e parë të shkruar dhe të vënë në skemë nga Fishta, më 1905 (ose me titullin e saj): deri tani dihej se kjo shfaqje ka qenë një komedi e Molierit, përshtatur nga Fishta (ose, siç shprehej Fishta, "simbas Molierit"), por titulli i saj nuk është "I ligu për mend" (Skanjeti, f.18), por "Mjek përdhuni" (Rrota e shkruan "Mjek i përdhunë").

Korrigjimi i dytë lidhet me Teatrin e Françeskanëve (Teatri i Françeskanëve, ndodhej djathas në oborrin e shkollës "Vasil Shanto"), i cili, sipas Rrotës, "kje ndërteu pak vjet na parë se ndërtesa e shkollës (1899). Ndërsa sipas Donart Kurtit "sallonit i teatrit kje ndërteu më 1899". Të dy korrigjimet kanë rëndësi të dorës së parë, sepse lidhen jo vetëm me një titull komedie, por me veprën e parë teatrore në gjuhën shqipe, që është një përkthim/përshtatje e komedisë së Molierit (Mjek përdhuni) dhe është jo vetëm pjesa e parë teatrore e shkruar dhe e vënë në skemë në qytetin e Shkodrës, por edhe në gjithë Shqipërinë (ose në trojet shqiptare se asokohe nuk kishte Shqipëri me kufij të shkruar në harta a defterë të çfarëdoshëm). Është, gjithashtu, shfaqja e parë në gjuhën shqipe luajtur në një teatër (sallon teatër), për ndërtimin e të cilit, siç na dëshmon Simon Rrota, fretim e Shkodrës së bashku me punëtorët rrezikuan shumë, për shkak të atyre "qi nuk dojshin ndërtesa, e, teatër, pa lejen e Stomollës (kryeqyteti i Perandorisë Otomane) mu mund t'u ndërtonte. Prandaj punëtorët u veshnin me zhguna (veshja e fretëve) si fretnit, për mos me ra në sy të qeverisë turke."

Ndërsa një korrigjim tjetër duhet të bëjmë duke vlerësuar teatrin e traditës, ashtu si na vjen nga piktori shkodran Simon Rrota:

"Çfaqjet teatrale qi u bajshin për të paren herë, në gjuhën shqip, për meritë të letrarit të famshëm Atë Gjergj Fishta, nisën të baheshin shumë tërheqëse për vendin tonë e sidomos për gratë pse ato nuk kuptojshin italishten, ndërsa djemt e burrat e zotnojshin mirë atë gjuhë e të thuejsh, as der mend nuk i shkonte gjuha amtare..."

\*Studues i Fishtës



## DEBATI

Fatmira Nikolli

# BIE LIGJI I TEATRIT

## Hapja e thirrjes për projekte, Mazniku: Do të ketë garë

Hapat që do të ndodhin tani do të jenë: Do të kemi një amendim të ligjit. Amendimi do përbëjë mundësinë e garës, që kompani persona apo institucione të tjera që kanë mundësi të konkurrojnë apo e kanë një opsion alternativ t'ia propozojnë këtë komisionit të shqyrtimit. Ka një datë parlamenti shqiptar, i cili do të shqyrtojë dekretin e presidentit dhe besoj që paralelisht me këtë do shqyrtohet edhe amendimi". Ka qenë kjo deklarata e djeshme në "News 24" e Arban Mazniku, nënkryetar i bashkisë së Tiranës.

Deklarata e tij, vjen pas letrës që i dërgoi Sekretariatit të Përgjithshëm të Kryeministrit Engjell Agaçi Shefja e Njësisë për Shqipërinë dhe Bosnje-Hercegovinën në Komisionin Evropian Michela Matuella. Në letrën e bërë publike ditën e hënë, ajo vlerësoi qëndrimin e ri të ekzekutivit shqiptar, për të amenduar ligjin, me qëllim prezantimin e një thirrjeje të hapur, për zbatimin e projektit për Teatrin Kombëtar, ku çdo kompani private mund të dorëzojë një propozim për projektin.

Por, çfarë nënkupton kjo? Së pari, rënien e ligjit.

## LIGJI

Ligji që u miratua në parlament me 5 korrik, nuk u dekretua nga presidenti Ilir Meta në fund të të njëjtit muaj. Ky e fundit, bëri një opionencë të gjatë. Presidenti Meta vlerësoi se në kushtet kur Gjykata Kushtetuese nuk është funksionale dhe përgjegjësia fundore i bie atij për të vlerësuar kushtetutshmërinë e ligjeve, ta rikthejë atë në Kuvend "me qëllim që kjo çështje, të marrë kohën dhe vëmendjen e duhur, për t'u vlerësuar përsëri nga Kuvendi". "Ky ligj shkel parimet e 'barazisë përpara ligjit' dhe 'lirisë së veprimtarisë ekonomike të shtetasve', parime këto të cilat gëzojnë një mbrojtje të veçantë nga Kushtetuta. Sipas tij, ky ligj "cenon

rëndë parimet kushtetuese të ndërtimit dhe funksionimit të organeve të pushtetit vendor të 'decentralizimit' dhe 'autonomisë vendore', duke rënë ndesh njëkohësisht edhe me parimin e ndarjes dhe balancimit të pushteteve". Por çfarë thotë ligji konkretisht? Ai ka për objekt përcaktimin e procedurës së veçantë për negociimin dhe lidhjen e kontratës me objekt realizimin e projektit të zhvillimit të zonës së Teatrit Kombëtar, duke përfshirë projektimin, ndërtimin dhe dorëzimin e godinës së re të Teatrit Ko-

mbëtar. Në nenin 2 bëhet me dije se qëllimi i këtij ligji është realizimi i projektit për zhvillimin e një zone urbane në qytetin e Tiranës dhe ndërtimin e godinës së re të Teatrit Kombëtar me partner privat. Ai përcakton se në dispozicion të zhvillimit të projektit vihen pasuritë e paluajtshme në pronësi shtet, sipas parashikimeve të këtij ligji, Kodit Civil dhe legjislacionit për pronat e paluajtshme. Neni 5 thotë se Komisioni i Negocimit të kontratës vlerëson dhe negocion me partnerin privat shoqërinë "Fusha" sh.p.k. propozimin e paraqitur prej tyre dhe harton kontratën finale të negociuar nga palët, shoqëruar me relacionin përmbyllës të negociatave, brenda një afati kohor prej 30 ditësh nga data e ngritjes së komisionit.

Neni 8 thotë se miratimi i kushteve të kontratës së

Teatri shpëtoi nga ligji, por jo nga shembja



negociuar do të kalojnë me dhënie pëlqimi në parim nga Këshilli Bashkiak me shumicën e votave, në prani të më shumë se gjysmës së të

gjithë anëtarëve të këshillit dhe do të dërgohet zyrtarisht nga Bashkia Tiranë pranë ministrive të përmendura në pikën 3 të nenit 6 të

këtij ligji, me qëllim dërgimin për miratim në Këshillin e Ministrave. Me të gjithë këto pika, por sidomos me përcaktimin e privatit që do të bënte ndërhyrjen, ligji aktual praktikisht bëhet nul. Për të realizuar të njëjtën ide dhe me PPP si fillim, bie ligji ku përcaktohet kompania fituese dhe njëherësh, bie edhe projekti. Jemi pra, në fazën fillestare: pa një ligj e pa një projekt. Kemi vetëm njerëz të lodhur që kanë konsumuar kohë e ide për të mbrojtur teatrot, sepse janë dy dhe jo një, e në anën tjetër një qeveri që rreket të mbajë në këmbë një ligj që nuk ka më pas paterica.

Dje, nënkryetari i bashkisë Arban Mazniku ftoi opozitën të bashkëpunojë në hartimin e ligjit të ri. "Në qoftë se opozita do të kishte ardhur në komision dhe në vend që të ngrinte karrige e

taolona, të bërtiste e të bllokonte komisionin, të vinte me një propozim specifik për mënyrën si ligji mund të bëhej më i mirë, ju siguroj që do ishim të gjithë të gatshëm" – theksoi ai dje.

Sa i takon procedurës që do të ndiqet në raport me dekretin presidencial, Rregullorja e Kuvendit përcakton qartë hapat. Dekreti do të shqyrtohet në komisionin përgjegjës, që është Komisioni i Veprimtarive Prodhuese. Referuar Rregullorës, brenda 8 javëve nga data e fillimit të shqyrtimit, komisioni paraqet raportin. Parashikohet që komisioni parlamentar të mblidhet fillimjavën e ardhshme, ndërkohë që sipas përcaktimeve në mblidhjen e Konferencës së Kryetarëve, do kalojë për votim në parlament në secancën e 20 shtatorit

Nga Vladimir Myrtezai\*

Besim, komunikim i hapur dhe afritet është një trekëndësh që shënon një territor të personalizuar për artistin e ri Greg Rama, i diplomuar pak vite më parë në Universitetin e Arteve në Tiranë. Si përpara çdo subjekti, në trokitjet e para për t'u identifikuar, autori i kësaj ekspozite shpall sfidën e tij për të dalë përpara publikut, duke na kujtuar kështu ngërçin e madh të hapit të parë që përjeton çdo artist.

Përpos trashëgimisë familjare, ai përballet po aq edhe me nevojën për një stacionim të mendimit dhe aktit krijues, duke i besuar më shumë ndijmeve dhe përvojave personale si *conditio sine qua non* për krijimtarinë.


Besimi i hapur mbi çfarë mund të gjente në korrentet e eksperimentit shoqëruar me një intuitë premtuese që e lidh artis-



tin me shenjën, tingullin dhe dendësinë e formës me të cilën afrohet, i hapin atij një rrugë të qenësishme ku përfshihet të besojë.

Përmes lojës me hapësirën ai ndërton një ekuilibër mes konceptit dhe trupëzimit të një energjie që e identifikon duke i hequr gravitetin arkitektonik mediunt, duke përdorur po aq edhe një lloj transfigurimi thjeshtëzues drejt trajtave elementare e parake.

Pika, vija, rrafshi, mungesa e gravitetit bashkërdohen për të (ri)lexuar konceptin e një ndërhyrje hapësimore, jo më si një ngjarje lineare, por me asoci-



ime qëndrimesh të aksidentuara e vertikale, duke na afruar atë përvojë që mund

## VLADIMIR MYRTEZAI: NJË "FIDEM" NGA GREG RAMA

ta quajmë vëllim i shformuar elementesh ose energji e kulturar shpirtëror.

Perceptimi është i pakohë dhe larg analizës së zhvendosur në kohë, sepse koha në këtë rast ekziston vetëm si një element i qëruar nga rrethanat tipizuese, duke shfrytëzuar ecejaket e një ndjeshmërie të veçuar.

I vetëmjaftueshëm në elemente krejt të thjeshtë, por shumë pranë një sinkroni energjish që zhbën narrativën apo rrethanat *site-specific*, autori krijon veprën dhe gjuhën e saj në të njëjtën kohë.

Greg Rama ka një shprehje të "lindur", në afri me fjalën, të shkruarit dhe komunikimin; ndaj dhe shfaqja e tij e parë nën kupolën *Fidem* – "Besim"/"Vërtetësi" përvijon një lëvizje komunikuese nëpërmjet një mediami, i cili përfshin hapësirën ku ai zhvendos strukturën e tij.

Fuqia e interpretimit dhe e asociimit krijon një territor kulturor të ndërmjetëm ku frymon ndjesh-

mëria e artistit.

Autori e ndien veten në rrokullimat e shpesh-ta mohuese, aq domethënëse për një artist në rritje, për të hapur kështu rrugën e tij, që tanimë i duhet ta ndajë edhe me publikun, si një mundësi për të rimenduar dhe riparë shesh-pushtimit si akte ndikimesh të panjohura apo të rishikuara artistike.

Greg Rama vjen si një komunikim i pamundur i gjithë atij monologu të brendshëm e kaotik që së shumti nuk ndahet drejtpërdrejt, por i kamuflluar përmes gjuhës së ndërmjetësuar të artit.

Dalja e tij e parë në publik është pikënisja e këndvështrimit i hapur që do të mundësojë hapjen e tij të radhës në kurajën e parashikimit e ndërjegjes së tij si artist në një rrugë të gjatë e të vështirë.

\*Kurator i ekspozitës

Opinion i Ditës

# Zoti dhe shkolla!

Nga Andon Andoni

(vijon nga faqja 1)

... edhe politikanët, niveli lokal dhe i lartë i qeverisjes për të uruar "Suksese dhe një vit të mbarë!"

Me idenë për të shkruar këto radhë për fillimin e një viti shkollor, kërkoja thuasje të gjitha fjalimet e politikës që janë mbajtur gjatë këtyre viteve të demokracisë dhe gjeta thuasje në të gjitha rastet, këtë slogan urimi: "Suksese dhe një vit të mbarë shkollor", ose "Fillim të mbarë, mësues dhe nxënës në udhën e dijes" dhe gjatë gjithë kohës shtoja pas këtij urimi gjithëpërfshirës, atë çka do kisha dashur shumë të dëgjoja, qoftë edhe për tingëllimë: "Zoti ju bekoftë!"

Askund. Dhe të mendosh, që për një bekim të tillë ka nevojë më shumë se kushdo shoqëria shqiptare, e dalë nga një ateizëm gjysmëshekullor vulgar dhe sidomos fëmijët e shkollave, grumbulluar në mjedise shkollore, në vigjilje të nisjes së një viti të ri shkollor.

Togfjalëshi i "besimit tek Zoti" nuk është se nuk njihet, por denduria e përdorimit të tij dhe ngarkesa emocionale që duhet të përcjellë tek ne në shoqëri nuk janë aty ku duhet dhe aq më pak të ngrëthyer natyrshëm tek institucionet shkollore dhe rinia, ku thuasje ka munguar fare.

Shpesh në fillimet e vitit shkollor, media dhe portale të ndryshme, pa lënë mënjane edhe politiken, e kanë sjellë në vëmendje letrën e presidentit Linkoln, të 1830-ës, drejtuar mësuesit të djalit të tij në ditën e parë të shkollës. Një dokument që iu ka mbijetuar shekujve dhe si e tillë është aktuale dhe plot frymëzim për këdo që merret me edukimin dhe shkollën, por në funksion të shkrimit tim, do citoj vetëm fjalën e fundit të kësaj letrë, - busull në orientimin e edukimit! "... Mësojeni atë (tim bir-AA) të ketë besim... në njerëzimin dhe në Zotin".

Por fatqësisht, mësuesi ynë as që mund ta cekë gjëkund emrin e Zotit, përjashtuar rastet e rralla kur ai përmendet në ndonjë tekst të kurrikulës, lëndë a kapitull, apo ndonjë pjesë letrare, me qëllime të intertekstit. Ndonjëherë mund ta përmendë vetëm në mënyrë instiktive, kur kërkon të shpëtojë prej telasheve të së përditshmes dhe fare pak prej dëshirës për të promovuar, proklamuar apo besuar tek fryma e Tij. Kurrikula e shkollës sonë, edhe pse përpjetat ta përfshijë brenda kornizës së saj qasjen ndaj besimit fetar dhe Zotit, është kaq e ftohtë dhe sipërfaqësore në interpretimin e frymës dhe laike, sa që do t'ia kishte zili shoqëria më e qytetëruar dhe liberale e globit.

Në të shkuarën, kjo shkollë nuk ka qenë kaq indiferente ndaj besimeve tek Perëndia. Veçllarshi ka futur në "Evëtar" në faqet 27 dhe 28, gjashtëmbëdhjetë strofa mësimi nga "Dhiata e vjetër". Ndërsa në "Evëtarin" e 1844-ës, gjendet strofa e një poezie shqipe me titull: "E par" e të msuarit frikë e perëndisë" të vendosur në faqen e parë.



"Çdo e nisur q' është e rendë/S'ka njeri që nuk e di/ Por kushdo kur do të vihet/Si shpëton gjësend Ati".

Pa më të voglin mëdyshje, nisur nga tradita e shkrimit të shenjtë, këto vargje të Veçllarxhit shprehin kuptimi tropologjik, i cili përmban një kuptim moral, individual, nëpër të cilin Zoti qorton apo lëvdon, por nga ana tjetër, edhe pse jemi në një shtat kohor dhe shoqëror tejet të provokuar nga mungesa e shkencës, arti dhe kulturës së mirëfilltë, motivi i parë i tyre është ngulitja e besimit dhe pastaj predikimi.

Ndërsa në "Fare i ri Evëtar" shqip për djelm nisimtarë, vëllimin e 1845-ës, vendosi një tjetër katërvargësh:

Kurëkush me ment' të vet/ Mos mburetë se ndiq flet/ Pa dashtun i madhi Zot/Fletë pema s'leshon dot.

Këto katër vargje kanë në themel një perceptim filozofik të jetës njerëzore, e cila është ngritur mbi dituritë e paraardhësve, mbi trashëgiminë e madhe të njerëzimit, përmes ciklesh të pandalshme zhvillimi, nga lindja deri në vdekje me dëshirën e Zotit.

Kjo qasje do vijonte për shumë kohë, tek autorë dhe abetare të ndryshme të shkollës shqipe. Madje, pikërisht këto katër vargje zunë vend edhe në ballinën e abetares së Stambollit.<sup>2</sup>

Do vijonte kjo traditë edhe më 1896 tek "Mësime të vjera a fjalë shpirtërishte" botuar në Kostandinopojë, me kryetitull: "Perëndia dëftën dashurinë e tij mbi ne, sepse kur ishim neve edhe po fajtoje, Krishti vdiq për ne", për të ardhur më vonë në fillim të shekullit të ri, ku sërish në programet e shkollave, ekziston kapitulli lëndor i quajtur "Besimi" me 4 orë javore që nga shkolla fillore<sup>3</sup> dhe me botime të tilla tekstore të "Komisës

Letrarë", që çelte faqen e parë të këndimit në vitin 1917, me "Zani i Natyrës"; "Shka flet tue shdritun, prej s'naltit diell!/ Shka flet stolisun me hyj plot qiell,/ Se mbi ta Zoti e ka selin./Njeriu t'a din.

Duke ardhur në shkollën laike të mbretërisë shqiptare, vëmë re se humbasin dedikimet tekstore për Zotin dhe Perëndinë, ndërsa mbetet fryma e besimit tek to, do vinte dita, që si për ironi të fatit, diktatura komuniste, "me urdhër nga lart dhe iniciativë nga poshtë" do ta niste shkatërrimin dhe përcudnimin, mohimi dhe braktisjen e Zotit dhe besimit fetar, pikërisht nga shkolla dhe rinia shkollore, në pranverën e 1967, nga gjimnazi "Naim Frashëri" i Durresit<sup>4</sup>.

Por le të kthehem tek thelbi i shkrimit, pasi kemi bërë një historitë të shkurtër të qasjes së shkollës sonë ndaj fesë dhe besimit fetar.

Përpara dy viteve u lakua nga kryeministri Rama ideja e futjes së besimit të fesë në shkollë.

"Dituria mbi kulturën e besimeve është njëra ndër rrugët që duhen hapur me kurajë dhe vullnet të madh për të mbrojtur fëmijët tanë nga ekstremizmi i çdo forme dhe për t'i pajisur ata me një armë të domosdoshme në mbrojtje të thesarit tonë të çmuar të bashkëjetësës fetare", - shkroi kryeministri në atë kohë. Sigurisht që një qasje e tillë do kishte dhe provoi kundërshtitë, por dhe mbështetje, gjë që nuk u vunë kurrë në balancë për të parë përfundimet, qoftë edhe përmes ndonjë anketimi a sondazhi të mundshëm. Personalisht mendoja me shpresë se kjo do ishte një sjellje primare për të vendosur diçka në balancën e prishur të shoqërisë sonë prej një gjysmë shekulli.

Nga njëra anë, ata që kundërshtojnë propozimin e Ramës argu-

mentojnë se: mësimi i fesë kundërshton vetë natyrën e një shteti laik dhe me gjasë më dukej se ishin që të gjithë ata që në ditën e parë të shkollës, "bezdisheshin" të shtonin pas fjalëve përrumore, "Zoti qoftë me ju". Një palë akuzonin cilësinë e dobët të mësimdhënies, që me gjasë do rëndojë edhe më nga një doktrinë fetare e përfshirë në kurrikulë. Aspak e vërtetë, madje pohoj me bindje se një lëndë e tillë e menduar dhe inkuadruar mirë, do t'i shtonte vlerat e cilësisë së shkollës dhe mësimdhënies, do ta bënte nxënësin dhe trupën mësimore pedagogjike edhe më të mire e më të dashur<sup>5</sup>. E vetmja gjë që duhej zgjidhur mes specialistëve të kurrikulës dhe atyre të hartimit të teksteve dhe programeve, do ishte kërçitja mes teorisë së evolucionit së Darvinit dhe gjenetës së jetës sipas librave të shenjtë. Kisha katolike ka kohë që e ka pranuar teorinë evolucioniste dhe Papa Françesko është Papa i parë që po hoji publikisht se evolucionin është në përputhje me mësimet e kishës. Përsa i përket islamit, dimë që në vitet e arta nga 662 deri 1258, dijetarët myslimanë ishin në ballë të inovacioneve shkencore në fusha të tilla si mjekësi, astronomi dhe matematikë.

Por, asnjë nga këto kundërshtime nuk është në gjendje, të bindë për gabim në futjen e një lënde që do sillte pozitivitet në jetën shoqërore të individit, me praninë e besimit tek Zoti. Megjithatë, stepja prej dy vitesh e më shumë, i marrjes jetë të këtij projekti, duket se e ka zvetënuar dhe rruadur punën e nisur nga grupet e punës dhe ministria e Arsimit dhe Sporteve, pa mohuar edhe ndonjë arsye teknike në vështirësinë e zgjidhjes së ngërçit.

Thuhet që niveli i shkollës që kemi është më i ulët nga sa do parapëlqenin specialistët e teorisë

së përfshirjes së fesë në shkollë. Por ky le të jetë një objektiv i rëndësishëm i politikave të shtetit kështu dhe në të ardhmen. Futja ose mosfutja e orës së fesë nuk mund të përcaktohet nga kjo situatë. Por kjo le të shërbejë për hapjen e diskutimit mbi nevojën e cilësisë në shkollimit që po nxjerr mjekët, mësuesit e brezave të rinj, sociologët, psikologët, avokatët, juristët e gjykatësit e tanishëm dhe politikanët e të ardhmes. Një shkollim i duhur dhe cilësor është një nga kriteret kryesore që bën një shoqëri të ecë përpara e të zhvillohet. Arsimimi nuk mund të eliminojë injorancën, por mund ta zvogëllojë atë, qoftë e dhe përmes besimit tek Zoti.

Ora e fesë duhet parë si lëndë brenda sistemit edukativ, e lënë e lirë në frekuencim. Qëllimi duhet të jetë promovimi i shtetësisë përfshirëse dhe respektit, promovimi i njohurive mbi faktet për të kuptuar konceptet dhe rregullat bazë të fesë, artin, historinë, muzikën, literaturën, simbolologjinë e praktikën e feve. Fëmijët duhet të kenë informacion mbi besimet për të cilat dinë pak ose nuk dinë asgjë. Mësimdhënia e lëndës së fesë nuk e kthen shkollën në fetare. E funksionimi i mirë i demokracisë varet edhe nga niveli i njohurive të qytetarëve të saj, me besim tek Zoti.

Harmonia e besimeve fetare, (brenda familjes së autorit të këtij shkrimi, ekzistojnë të katër besimet fetare më të mëdha të vendit) duhet shoqëruar me doemos me forcimin e kulturës së besimit për secilin sekt. Shpesh ulemi pranë tavolinës së kremtimit të Bajramit, Pashkëve dhe Hashures, por pa pasur ndonjë vëmendje të duhur për të ndjekur dhe ritet e zakonet e tyre të moralit, të së mirës dhe virtytit. Shoqëria jonë është laike dhe sekulare, por kjo nuk do të thotë se brenda saj nuk ka besimtarë, ose se ata janë një pakicë. Kurioz është fakti se shkollat që menaxhohen nga lëvizje fetare të ndryshme, janë ndër më parësoret në cilësinë e mësimit dhe frekuencimit i tyre bëhet mbi bazën e cilësisë së shkollimit dhe jo përkatësisë fetare.

Propozimi i kryeministrit mbeiti në haresë. Shteti laik që ka në themelet e tij njohjen e lirisë së kultit dhe kjo është e sanksionuar në kushtetutën tonë ashtu si në të gjitha demokracitë liberale. Kur është fjala për edukimin fetar në shkollat publike qëllimi nuk duhet të jetë ekspozimi i parimeve teologjike dhe shpërndarja e dogmave, por ilustrimi kritik dhe historikisht në kontekstin e kohës i përmbytjes së feve.

Atëherë edhe mësuesi, edhe drejtori i shkollës, edhe politikanin në ditën e parë të shkollës do kenë të drejtën dhe arsyen ta mbushin gojë plot: "Urime dhe vit të suksesshem, me bekimin e Zotit!"

(Footnotes)

<sup>1</sup> Sabri Hamiti, "Poetika shqipe", Shtëpia Botuese 55, Tiranë 2010, f. 294

<sup>2</sup> Shefik Osmani-Njazi Kazazi, "Abetaret shqipe dhe trajektorja e tyre historiko-pedagogjike", Sh. B. Librit Shkollor, Tiranë 2000, f.107

<sup>3</sup> Programe për shkollat fillore pesëklasësh" Tirana 1938, faqe 5



Dje në "Deutsche Welle"

# Politika kthen djathtas kudo në Europë

Christoph Hasselbach

(vijon nga faqja 1)

## ITALI

... më përpara se Demokratët Suedezë. "Lega Nord" vërtet që zuri vendin e tretë në zgjedhje, por bashkë me lëvizjen "Pesë Yjet" ajo u fut në koalicion si partneri më i vogël. Që atëherë, Salvini sundon skenën politike europiane me një politikë të fortë kundër të huajve, ai është aq prezent, sa madje disa e mbajnë atë për kreun e qeverisë. Gjuha e tij nxitëse dhe politika kundër të huajve gjejnë rezonancë. Gati 100 ditë pas hyrjes në koalicion, "Lega Nord" ndodhet në krye të sondazheve me 30%. Kujtojmë se në zgjedhje ajo arriti vetëm 17% të votave. Në drejtim të Merkelit, Salvini tha se ajo "nënvelehtësoi rrezikun e konflikteve sociale, kur mendoi se kishte vend për qindra mijë njerëz në Gjermani".

## AUSTRI

Partia populiste austriake e lirisë, FPÖ ka pasur përvojë qeverisëse më të gjatë. Në vitin 1999, kjo parti doli partia e dytë më e fortë në zgjedhjet e atëhershme parlamentare dhe krijoi një koalicion me ÖVP. Tani po kjo aleancë qeveris nga viti i kaluar me kancelar, Sebastian Kurz. Por FPÖ nuk duhet të luftojë shumë për një kurs të fortë në politikën e azilit. Sebastian Kurz vetë u zhvendos djathtas me politikën e tij për të mbajtur refugjatët larg Austrisë. Por FPÖ shkon edhe një hap më tej. Ministri i Brendshëm, Herbert Kickl kërkon t'i mbajë refugjatët "të përqendruar", gjë që sollti regjime të forta dhe akuzën se ai po përdor gjuhën e nacional-socializmit.

## GJERMANI

Në zgjedhjet e Bundestagut në shtator 2017, Alternativa për Gjermaninë, AfD arriti 12,6 të votave dhe me 94 vendet në Bundestag është partia e tretë më e fuqishme, dhe partia më e madhe opozitare. Miratimi për këtë parti vazhdon të rritet. Në sondazhet e fundit kjo parti ka arritur 15% të votave dhe nganjëherë ajo arrin të kalojë vetë Partinë Socialdemokrate. Në disa sondazhe në Lindje AfD madje kryeson, duke kaluar edhe partinë CDU. Edhe pse ekspertët e politika e akuzojnë këtë parti për afrimitet me ekstremistët e djathtë dhe kërkojnë që të vëzhgohet nga Mbrojtja Kushtetuese, duket se asgjë nga këto nuk e ka dëmtuar AfD-në. Së fundmi, kjo parti pritet të hyjë edhe në dy parlamentet e fundit të landeve në Bavari më 15 tetor dhe në Hesen më 28 tetor.

## FRANCË

Kur Marinë Le Pen nga Front National doli në raundin e dytë përballë Emmanuel Macron, shumë vëzhgues kishin theksuar se bëhej fjalë as më pak e as më shumë, por për të ardhmen e Europës.



Proeuropiani Macron fitoi dukshëm përballë Marine Le Pen 66% kundrejt 34%. Prej atëherë, duket sikur Le Pen doli nga skena, në fund ajo arriti të ndërrojë emrin e partisë në Lëvizja Kombëtare e Përgjithshme. Por shumë përkrahës presin që mbesa e Le Pen, Marechal Le Pen të marrë ti-

monin për ta arritur me të fitoren. Megjithatë, edhe në Francë armiqësia ndaj të huajve dhe skepticizmi ndaj Europës janë bërë pjesë normale.

## HOLANDA

Para zgjedhjeve parlamentare në Holandë në mars 2017, në të gjithë Europën sundonte paniku

mes partive tradicionale se çfarë rezultati do të arrinte Partia e Lirisë PVV e Geert Wilders. Rezultatet treguan se kjo parti nuk doli triumfuese, por me rezultatin 13%, kjo parti zuri vendin e dytë, ndërkohë që socialdemokratët gati u shuan politikisht. Pas koalicionesh të vështira u arrit më në fund të krijohej një aleancë e qendrës më të djathtë. Por Wilders me qëndrimin e tij refuzes ndaj migrantëve dhe islamit vazhdon të sundojë skenën politike në Holandë. Ndërkohë, me Thierry Baudets është krijuar një parti tjetër e ekstremit të djathtë, që ndjek qëllime identike si Wilders. Baudet paraqitet si njeri i kulturës, luan piano dhe flet latinisht, duke iu drejtuar kështu shtrës së arsimuar. Kështu, djathtët nuk do i marrin vota njëri-tjetrit, por më shumë do t'i shu- mojnë ato.

Në sondazhet e fundit kjo parti ka arritur 15% të votave dhe nganjëherë ajo arrin të kalojë vetë Partinë Socialdemokrate. Në disa sondazhe në Lindje AfD madje kryeson, duke kaluar edhe partinë CDU. Edhe pse ekspertët e politika e akuzojnë këtë parti për afrimitet me ekstremistët e djathtë dhe kërkojnë që të vëzhgohet nga Mbrojtja Kushtetuese, duket se asgjë nga këto nuk e ka dëmtuar AfD-në.

## HOROSKOPI

### DASHI

Duhet të përfshihen në aktivitete sportive. Qëndroni larg personave që përpiqen t'ju mësojnë zakone të këqija. Duhet të përdorni sa më shumë kontakte për të zgjidhur disa çështje shumë të vështira. Ka gjasa të udhëtoni, por do të shpenzoni shumë.

### DEMI

Mund t'i zgjidhni problemet vetëm duke menduar pozitivisht. Shmangni investimet afatgjata dhe përpiquni të dilni në mbërnie me miqtë tuaj. Presioni në punë dhe shtëpi mund të bëjë që të humbni durimin. Bëni kujdes me fjalët, pasi mund të futeni në telashe.

### BINJAKET

Mbështetja e familjes do t'ju bëjë që të çlirohni nga tensioni. Mendoni mirë para se të investoni diku sot. Ka gjasa që t'ju testojnë në punë. Mblidhni forcat për të dhënë rezultatin e duhur. Bashkëshorti/bashkëshortja juaj do t'ju vijë në ndihmë në një moment të vështirë gjatë ditës.

### GAFORJA

Shëndeti i bashkëshortes/bashkëshortit tuaj do t'ju shqetësojë, ndaj duhet të bëni të gjitha kontrollet e nevojshme mjekësore. Tregoni takt kur të flisni me kolegët. Mbikëqyrja juaj e fortë do t'ju bëjë që të jeni mbi të tjerët.

### LUANI

Ka arthur koha të mos keni më frikë, pasi kjo ju ndikon negativisht. Shpërfilini ata që ju afrohen vetëm për interes. Ka gjasa që të vizitoni një vend fetar ose të shkoni tek një i afërm juaj. Mos u tregoni emotiv gjatë takimeve për biznes, pasi do t'ju dëmtojë reputacionin.

### VIRGJERESHA

Problemet mund të shkatërrojnë lumturinë tuaj. Vullneti dhe puna juaj e lodhshme do të vlerësohen dhe për këtë do të shpërbleheni financiarisht. Disa të afërm të mosuar ka gjasa t'ju bëjë disa pyetje të paarsyeshme.

### PESHORJA

Do të gëzoheni për suksesin e disa personave të tjerë, të rëndësishëm në jetën tuaj. Është dita e duhur për piknik me bashkëshortin/bashkëshorten tuaj. Kjo jo vetëm që do t'ju lumturtojë por do t'ju ndihmojë për të zgjidhur mosmarrëveshjet.

### AKREPI

Do të arrini një marrëveshje të re financiare nga e cila do të përfitonni mjaft para. Mund të merrziteni për shkak të disa kushteve në shtëpi. Bëni mirë të dëgjoni mendimin e më të mëdhenjve.

### SHIGJETARI

Duhet të kontrolloni njerëzit. Bëni kujdes me shpenzimet, pasi mund të dilni jashtë buxhit tuaj. Do të jetë një ditë e mirë sa i përket anës romantike. Planifikojni gjërat astu sig duhet, në mënyrë që të merrni rezultatet që kërkon.

### BRICJAPI

Duke vepruar me zgjuari, do të zgjidhni disa probleme afatgjata. Mos shpenzoni shumë për argëtim apo për luks. Tregohuni në arsyeshem, sidomos me njerëzit që ju duan dhe kujdesen për ju. Partneri/partnerja juaj do t'ju mungojë gjatë gjithë ditës.

### UJORI

Ka gjasa të vuani nga një dhimbje e vazhdueshme në qafë ose shpinë. Kushtojni rëndësi kësaj, pasi mund të ndikojë në një dobësi të përgjithshme fizike. Pushimi është shumë i nevojshëm gjatë ditës së sotme.

### PESHQIT

Do të kaloni një ditë shumë të vështirë. Ka gjasa që presioni në punë t'ju imtojë. Filimet nuk do të jenë në nivelin që ju prisnit. Përgjegjësi në familje do t'ju rriten duke ju shkakuar tension. Ndërrhyrja e të tjerëve mund të dëmtojë marrëdhënien me bashkëshortin/bashkëshorten tuaj.



### Nënkampionët e botës shkërmoqen në Elke

## Spanja, 'tërmet 6 ballësh' Kroacisë

Spanja i ka dhënë një lekcion futbollit sot përfaqësueses së Kroacisë, e cila pavarësisht statusit të nënkampiones së botës, është kthyer me këmbë në tokë, duke u mundur me rezultatin e thellë 6-0. Iberikët kanë bërë ligjin që në pjesën e

parë dhe kanë shënuar me vazhdimësi në portën e kroatëve, të cilët dukeshin hije e skuadrës së admiruar në Saul, Asensio dhe autogoli i portierit Kaliniç bënë që ndeshja të vendosej që në pjesën e parë, pasi u mbyll me shifrat 3-

0. Por në të dytën furia spanjolle nuk u ndal dhe Rodrigo, Serxhio Ramos e Isko ndëshkuan çdo gabim të kroatëve, që u larguan kokulur nga stadiumi, pasi pësuan humbjen më të thellë në historinë e përfaqësueses së tyre.



### Vjen Napoli, Crvena Zvezda përgatit 'Ferrin'

Klubi i Crvena Zvezdës ka shitur sot në pak orë të gjitha biletat për tri ndeshjet e fazës në grupet e Champions League. Më 18 shtator kjo skuadër do të presë Napolin, më 6 nëntor Liverpoolin dhe më 11 dhjetor PSG-në. Radha e gjatë në pikat e shitjes së biletave ishte bërë që dje në mbrëmje, pasi interesimi i tifozëve serbë është jashtëzakonisht i madh për kthimin e skuadrës së tyre në Champions pas shumë vitesh. Stadiumi "Rajko Mitic" i klubit nga Beograda, i njohur si "Marakana", ka një kapacitet prej 55.538 spektatorësh dhe do të jetë plot për ndeshjen me Napolin. Natyrisht, ai që do ta vuajë më shumë këtë situatë do të jetë futbollisti shqiptar i skuadrës italiane, Eliseid Hysaj. Për të do të jetë një ferr ndeshja në fjalë, pasi do të jetë gjithë kohën në shënjestër të tifozëve të ekipit serb.

Në 10 ndeshje ai ka kryer 12 zëvendësime sapo ka nisur pjesën e dytë, që dëshmon mosbesim



Jeton Selimi

# Zëvendësimet në pushim, Panuçi është i paqartë

## Italiani nuk e ka shpjeguar këtë ngërç

Ndryshimet gjatë rrugës janë të një hura në futboll. Në raste të veçanta mund të përcaktojnë fatet e një takimi, sidomos kur një trajner vendos të prekë formacionin fillestar, duke aktivizuar lojtarë nga stoli, të aftë për të bërë diferencën. Sir Alex Ferguson kishte Solskjær, Portugalia fitoi Europianin me Eder që erdhi nga stoli, megjithatë kur një teknik pas thujtje çdo pjesë të parë ndryshon futbollistët, atëherë pikëpyetjet krijohen vetvetiu mbi njohuritë dhe cilësitë e një trajneri, sidomos kur këto lëvizje nuk sjellin asgjë. Kur Kristian Panuçi mori timonin e përfaqësueses shqiptare duke trashëguar punën e jashtëzakonshme të De Biasit, të gjithë e dinim që nuk kishim në stol Claudio Ranierin apo Del Bosquen në aspektin e eksperiencës, por iu besua ky post për shkak të motivimit maksimal që italiani kishte shfaqur në bisedat e tij me drejtuesit e federatës. Aftësitë e tij ende nuk i ka shfaqur dhe përshtypja e krijuar është se trajneri ka ende shumë dilema dhe më e keqja dilema që lidhen me veten e tij dhe zgjedhjet që bën. Në 10 ndeshjet që ai ka drejtuar deri më tani kuqezinjët, në 7 prej tyre ka ndërhyrë ose përpara përfundimit të pjesës së parë, ose



në startin e të dytës, duke kryer gjithsej 12 zëvendësime. Dikush mund të thotë që nga këto 7 takime, disa kanë qenë miqësore dhe trajneri mund të eksperimentojë, e vërtetë, por 4 kanë qenë sfida zyrtare, Panuçi ka kryer 6 zëvendësime pa nisur segmenti

i dytë i lojës. Në Maqedoni u larguan Kukeli e Llullaku për Bashën e Memushajn, në Spanjë Memolla i la vendin Agollit ndërsa Balliu, Sadikut, kundër Izraelit Guri qëndroi në dhomat zhveshjes me Balajn që mori qendrën e sulmit. Ndërhyrje të tilla mund të vijjnë nga

3 arsye, trajneri nuk ka qenë i kënaqur me zgjedhjet fillestare dhe ka vendosur të ndryshojë; e dyta, trajnerin nuk e bind skema dhe ndryshon aktorët në varësi të një tjetër moduli, diçka që e bëri ndaj Skocisë duke aktivizuar Prengën në vendin e Gavazajt, ose e fundit, ekipi

**ANALIZA**  
Kur Kristian Panuçi mori timonin e përfaqësueses shqiptare duke trashëguar punën e jashtëzakonshme të De Biasit, të gjithë e dinim që nuk kishim në stol Claudio Ranierin apo Del Bosquen në aspektin e eksperiencës, por iu besua ky post për shkak të motivimit maksimal që italiani kishte shfaqur në bisedat e tij me drejtuesit e federatës.



### Baloteli peshonte 100 kilogramë në verë

Pesha e Mario Balotelit është bërë çështje, pas akuzave të ish-sulmuesit të Juventusit, Boniek, i cili u shpreh se sulmuesi italian duket sikur ishte 15 kilogramë mbi peshë. "L'Equipe" e ka ndjekur këtë çështje dhe ka zbuluar se gjatë muajve të verës Baloteli kishte shkuar në 100 kilogramë. Në ditën e parë të përgatitjeve me Nisën, ku u paraqiti me 15 ditë vonë për shkak të zërave të merkatos, sulmuesi iu nënshtrua testeve mjekësore dhe në peshore u shfaq shifra 100 kilogramë, 12 kilogramë mbi peshë. Që atëherë ai nisi stërvitjen e fortë për të kapur formën optimale dhe në ndeshjen e parë zyrtare, më 31 gusht kundër Lionit, peshonte 94 kilogramë. Baloteli është ende larg formës së tij dhe kjo gjë u duk qartë në ndeshjen e Italisë me Poloninë, ku sulmuesi u kritikua ashpër për lojën, ndërsa për ndeshjen me Portugalinë ishte në tribunë. Trajneri Mançini tha se lojtari ka një problem muskolor, duke mos dashur ta bëjë çështje formën e dobët të Balotelit.

## MBROJTËSI I INTERIT

Jardhur pa shumë bujë tek Interi në verën e kaluar, Milan Skrinjar u kthye shumë shpejt në idhullin e tifozërisë zikaltër, duke bërë disa paraqitje fantastike, megjithëse në një moshë të re. Këtë merkato, shumë skuadra ishin të interesuara për të, por vetë mbrojtësi shprehej se dëshira e tij ishte të vazhdonte në Milano. Mediat italiane raportojnë se kanë nisur mosmarrëveshjet e para mes klubit dhe futbol-

### Skrinjar refuzon rinovimin, Mançester Junajtidi fërkon duart

listit, ose më saktë menaxherit të tij. Drejtuesit zikaltrë duan që t'i rinovojnë kontratën mbrojtësit Sllovak, duke i dhënë edhe një rritje page që arrin deri në 2.5 milionë euro, por kërkesa është më e madhe. Mbrojtësi ka kërkuar që të përfitojë të paktën 3 milionë euro në sezon, plus edhe bonuse të tjera në

bazë të performancës dhe rezultateve. Ditët në vijim, pritet që Interi të marrë një vendim, duke qenë se interes serioz për mbrojtësin ka shfaqur edhe Mançester Junajtidi, që është gati të paguajë një shifer të majme për shërbimet e tij dhe lojtarit mund t'i plotësojë kushtet që kërkon te zikaltrërit.

## HABIT ISH-TRAJNERI I ÇEKISË


### Jarolim: Meritoj ekzekutim publik

Trajneri i Republikës Çeke, Karel Jarolim, ka dhënë dorëheqjen nga drejtimi i kombëtares, pas humbjes me rezultatin 5-1, në miqësoren ndaj Rusisë, si dhe asaj ndaj Ukrainës në shtëpi për Ligën e Kombeve, me shifrat 1-2. Ka qenë vetë Federata Çeke e Futbollit që ka bërë me dije lajmin, ndërkohë që akoma më

shumë habisin fjalët e vetë trajnerit pas dorëheqjes. "Ndihej shumë keq, besoj se tani meritoj një ekzekutim publik. I gjithë faji është i imi. Skuadra tani ka nevojë për një shtytës të re", - është shprehur Jarolim. Jarolim drejtoi Çekinë në 22 ndeshje dhe arriti vetëm 10 fitore dhe 8 humbje. Ekipi i tij pësoi plot 28 gola.



**Fjalëkryqi (1)**



**HORIZONTAL**

1. Një është edhe tatami.
6. Eshhtë raketa europiane.
12. Mund të jetë kokosi.
13. Fillojnë teoremat.
14. Fernando, bomber spanjol.
15. Kufizojnë rastet.
16. Një i tretë në vit.
18. Entë Rajonale Civile.
19. Bëhen duke ndjekur.
22. Në fillin të valles.
23. Të fundit në dyqan.
25. Franchi në stadiumin e Fiorentina-s.
26. Perignon i champagne-s.
27. Një pjesë e nomenklaturës.
29. Një detyrim... mbi xhiro
31. Fund kurri
32. Janë edhe ato të fytyrës.
34. Satelit i Uranit.
36. Çela, që qe aktore
37. Ishin xhuxhë të Oberon.

39. Eshhtë bekim... prifti.
40. Janë sportistët në stafetë.
41. Populli i druidëve.
42. Fillojnë në bjeshkë.
44. Arte pa re.
45. Një intensive me shumë ilaçe.
47. Neill aktor.
49. Mirella këngëtare lirike.
50. Giorgio i modës.

**VERTIKAL**

1. Një material për kiit.
2. Një Tatum pianist.
3. Fillojnë praktikën.
4. Diftong teatral.
5. Bien me ballë të tilla.
6. Mbyllin fushatat.
7. Një garë mes cowboys.
8. Inicialet e Reitman regjisor.
9. Gjysma e arenës.
10. Janë ata që nuk janë të qetë
11. Torero i Carmen.
13. Ishin mongolët e Timurlengut.
16. U shkrua nga Camus.
17. Janë bukë si kuleçë.
20. Fillojnë javën.
21. Gjysmë mimize.
24. Përpilojnë akte juridike.
28. Emri i Grameno-s.
30. E famshmja Garbo e kinemasë.
33. Brad aktort.
34. Pak afeksion.
35. Vitet pa kufij
36. Thonë se ajo e thyer nuk nuk ngjitet më.
38. Eshhtë gjuhë... e veshit.
40. Eshhtë i pastër në mal.
42. Kingsley aktor.
43. Ruajnë pa ujë.
45. Fillojnë temën
46. Mbyllin një manastir.
47. Në hyrje të sallës.
48. Fund filmi.


**Fjalëkryqi (2)**

**HORIZONTAL**


1. Eshhtë klasik me tutu.
6. Javier, fantazist te Palermio.
12. Thyeret me dy kafshata.
13. Ai dhe ajo.
15. Bo aktore.
16. Terence aktor britanik.
18. Entë Ndërtimi Has.
20. Eshhtë moshë më e bukur.
21. Dhjetë angleze.
22. Në mes të Wolfgan dhe Mozart.
25. Inicialet e Presley.
26. Eshhtë nusja me vello.
27. Eshhtë membranë e syrit.
29. Fund janari.
30. Një metër në sipërfaqe.
31. Bartok kompozitor.
34. Një pjesë e kandidatëve
36. Pak iniciativë.
37. Një pemë.

**VERTIKAL**


1. Aktori që thirrej Face stone.
2. Eshhtë enë gjaku.
3. Litarët e Tarzanit.
4. Entë Autonome Mat.
5. Inicialet e Asimov.
6. Ishtë babai i Prokinit dhe Filomelës.
7. Inicialet e Dali.
8. Kështu i shkoni atij që s'i ecën.
9. Pak origjinale.
10. Emri i Descartes.
11. Eshhtë skuadra.
14. I absurdit ai i Samuel Beckett.
17. Të famshme të tilla të Zenonit.
19. Rousseau "Doganieri" i pikurës.
23. Bega komik.
24. Diftong në duar.
28. Eshhtë gabu i një pivot.
31. Stoker që shkroi Dracula.
32. Eshhtë byrek.
33. Kapak pa kufij.
35. King Cole i muzikës.
39. Martini që e këngëtare italiane
40. Një lumë i yni.
43. Kukulla e Ibsen.
44. Bamirri president.
45. Nuk ka tradhtari.
50. Një enë.
52. Kufizojnë lëvizjen.



**Gjeni ndryshimin**



Dy figurat kanë ndryshime nga njëra-tjetra



Përgjigja, ja cilat janë ndryshimet e figurave

**SUDOKU**

	7		5					9	
4		3						7	
5	6				1				3
	3						7		
6				5				4	8
9		5	7						6
	2	1	6					8	
	9						5	3	
				3					

Plotësoni vendet bosh në mënyrë që çdo kolonë të ketë numrat nga 1-9

**Përgjigje e sudokut të numrit të kaluar**

9	3	1	2	7	4	6	8	5
2	4	6	5	8	1	7	9	3
7	8	5	6	3	9	1	2	4
5	2	9	7	4	6	8	3	1
1	6	4	8	5	3	9	7	2
8	7	3	9	1	2	4	5	6
3	9	7	4	6	5	2	1	8
6	5	8	1	2	7	3	4	9
4	1	2	3	9	8	5	6	7

*Argëtim filozofik*

- Nëse kalon kufirin një herë, kufijtë nuk ekzistojnë më.
- Zgjidhni një punë që ju pëlqen, dhe kurrë nuk do të duhet të punoni as dhe një ditë të vetme në jetën tuaj..
- Kufijtë e një njeriu përcaktohen nga kufijtë e gjuhës së tij.
- Nga një pikë dhe në vazhdim në nuk ka më kthim. Kjo është pika që duhet arritur.

**KRIPTOSKEME**

**KRIPTOSKEME**  
Përgjigja e numrit të djeshëm

6	17	14	4	6	7	3	10	6	16	9	8	K	U	L	T	M	A	P	L	A	B	
11	18	13	8	5	7	2	1	6	1	11	O	R	E	K	A	S	T	I	L	E	R	
3	4	7	1	14	3	1	14	3	1	R	U	L	A	K	T	O	R	I	A	L	E	
1	8	1	7	10	1	2	3	14	9	6	9	B	K	L	E	O	P	A	T	R	A	
8	1	2	14	3	10	3	11	6	12	7	I	E	K	I	T	R	E	T	E	S		
10	1	7	3	1	16	1	4	3	16	6	12	1	L	A	M	E	K	E	R	M	A	T
3	7	3	14	13	7	1	14	1	9	T	E	R	M	A	T	A	R	I	C	E		
17	1	14	9	1	4	P	O	E	T	O	T	O	S	C	I	R	M	A				
12	6	6	4	6	9	5	7	9	1	B	R	E	D	H	I	A	I	R	K			
18	15	9	16	9	10	7	6	1	11	I	L	E	I	N	E	P	H	I	L			
8	1	9	18	15	6	14	6	12	7	1	A	N	A	L	I	T	I	K	E	A	M	I
5	12	6	17	18	7	3	10	3	1	16	S	E	T	E	S	K	I	C	A	T	O	

**PËNGJITJE E FJALËKRYQVE TË NUMRIT TË KALUAR**

M	A	K	U	T	E	R	I	T	I	M			
A	G	A	R	R	E	N	D	M	I	K	E		
L	I	T	A	R	E	T	E	S	O	R			
E	M	I	L	E	A	P	E	L	I	M	I		
E	L	E	D	E	P	O	Z	I	T	A	T		
A	T	E	K	A	P	A	N	O	N	E	T		
L	K	A	N	A	R	I	N	E	A	M			
E	S	S	E	N	D	A	M	E	A	N	A		
C	I	P	A	M	I	T	E	E	M	E	R		
M	I	K	A	T	E	T	E	T	I				
K	O	R	R	I	K	U	K	O	L	L	A		
U	N	A	Z	A	R	E	N	D	O	R	E		
M	I	R	A	N	D	A	B	I	S	H	I	I	
I	R	A	R	M	A	D	H	I	D				
T	O	R	A	P	A	R	A	T	E	T	U	M	A
I	N	R	I	M	O	T	E	T	U	M	A		
I	T	R	D	A	M	A	R	E	T	I	L		
I	A	K	O	T	A	N	T	O	D				
P	U	R	T	E	K	E	E	T	N	I	K	E	
P	E	R	S	E	T	I	N	T	I	M			
L	A	O	I	G	O	L	A	L	A				
I	H	R	T	P	E	T	E	R	I	K			
V	O	L	E	E	L	E	N	D	E	E			

**FJALËKRYQI (1)**

**FJALËKRYQI (2)**

*Thënie të mençura*

- - Dimë se çfarë jemi, por nuk dimë se çfarë mund të ishim.
- - Pa guxim, nuk mund të ketë të vërtetë, pa të vërtetën nuk mund të ketë virtut tjetër.
- - Shumë fëmijë, shumë shqetësime. Asnjë fëmijë, asnjë gëzim.
- - Për sa kohë që ka fëmijë të cilët janë të uritur, Zoti nuk ekziston!



maiora premunt / gjëra të mëdha na presin

# TRANSFEROHU NË UET

MUNDËSIA E DYTË PËR NJË EDUKIM CILËSOR

**DATA 03-13 Shtator 2018**

- Juridik i Përgjithshëm
- Financë & Bankë
- Menaxhim Biznesi
- Informatikë Ekonomike
- Shkenca Politike
- Marrëdhënie Ndërkombëtare
- Psikologji
- Sociologji – Antropologji Sociale
- Komunikim – Marrëdhënie Publike
- Komunikim Dizajn

Adresa: Bulevardi Gjerq Fishta, Nd. 70, H.1, Tirane, Cel. 069 20 16 816, info@uet.edu.al, www.uet.edu.al



## www.gsh.al GAZETA SHQIPTARE



- Na mermi!
- Na shkruani!
- Na lexoni!

# Gazeta e gjithë shqiptarëve!



Kontakt: +355 68 40 63 842

- Facebook: Gazeta Shqiptare
- Instagram: gazetashqiptare.al
- Twitter: Gazeta Shqiptare
- E-mail: gazetashqiptare.al@gmail.com
- Youtube: Gazeta Shqiptare

